



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Proceverbal

Nga seance e nëntë (9) e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur më 30.11.2015 me këtë;

R E N D P U N E

- 1** Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2.1 Informatë rreth ndërtimeve në Komunën e Gjiçanit
 - 2.2 Projekt Rregullorja mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale nr. 01. nr. 8355 të datës 09.07.2010
 - 2.3 Projekt Plani strategjik lokal për trajtimin dhe parandalimin e Korrupsionit
 - 2.4 Draft Plani lokal i veprimit për riintegrim
 - 2.5 Propozim Vendimi për themelimin e Grupi punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit.
 - 2.6 Riorganizimi i përbërjes së Komiteteve të KK-Gjiçan
 - 2.7 Informatë për gjendjen në Teatër
- 3** Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.10 min

Në punimet e Seancës së nëntë morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri

Zv/kryetari i Komunës, Rexhep Kadriu,

Drejtorët e drejtorive Komunale,

Përfaqësuesja e OSB-së, zonja Sadete Ternava

Përfaqësuesi i OJQ “Anamorava” Isa Shefkiu

Përfaqësuesi i Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, z. Fazli Abdullahu

Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu

Zyrtari Ligjor, Hevzi Matoshi

Zyrtari për Informim Ilmi Musliu dhe zyrtarët e tjerë për informim nga Zyra e Kryetarit

Zyrtari për Integritet Evropian, Burim Elezi

Seancën e hapi dhe udhëhoqi kryesuesja e Kuvendit, zonja Valentin Bunjaku – Rexhepi e cili i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, z. Lutfi Haziri, zv/kryetarin e Komunës, z. Rexhep Kadriu dhe të gjithë ata që i monitorojnë punimet e seancës së nëntë.

Në vijim u kërkuar që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e seancës së nëntë.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar

Nga ana e sekretarisë u verifikua, se në punimet e seancës së nëntë ishin prezentë 34 anëtarë të Kuvendit, kur një mungoi: Fatbardhë Selmani

Kryesuesja kërkoj që si pikë e parë e rendit të punës së seancës të jetë debati për gjendjen në Teatrin e Gjilanit, kurse pas kësaj pika të vazhdohet me pikat e tjera ashtu siç është paraparë në rendin e punës.

Propozimi i kryesueses u aprovua me 23 vota për, 1 kundër, kurse të tjerët abstenuan.

Në vijim kryesuesja e hapi debatin për rendin e punës.

Fehmi Sylajmani- iu përshëndes të gjithëve, por siç jemi njoftuar sot ka ndërruar jetë profesori i nderuar Nuhi Ismaili i cili ishte një krijues të cilin humbëm ne dhe shumë nxënës, prandaj kërkoj një minutë heshtje për ta nderuar këtë njeri të spikatur. Gjithashtu kërkoj që në ora 12 të kemi një pushim në mënyrë që të marrim pjesë në ceremoni të varrimit.

Kuvendi e miratoi kërkesën e z. Sylejmani dhe të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit e tjerë mbajtën një minutë heshtje.

Sahit Abazi- iu përshëndes të gjithë dhe aktorët e Teatrit të cilët sot janë në këtë sallë, sepse është një pikë e rendit të punës ku do të debatohet për gjendjen në Teatër.

Ne kërkojmë që të diskutohet edhe për raportin e KDI-së, sepse është një manipulim sa i përket nivelit të transparencës në Gjilan. Në një anë thuhet se Komuna e Gjilanit është Komuna më transparente, kurse nëse e shikojmë realisht te ekzekutivi ka stagnim të transparencës dhe vlera e koeficientit vitin e kaluar ishte 24.3, kurse Komuna e Prishtinës e ka kaluar Gjilanin me transparencë. Sa i përket Kuvendit niveli i transparencës vitin e kaluar ka qenë 29.4, kurse tash është 24.3. Siç po shihet se kemi një regres sa i përket nivelit të transparencës, prandaj në fund të rendit të ditës kërkojmë të diskutohet edhe për raportin e KDI-së.

Mirëpo e kam edhe një pyetje për drejtorin e Arsimit: “sa është e vërtetë se Shkolla Fillore “Selami Hallaçi” nuk ka mbajtur mësim, sepse nuk ka pasur ngrohje”?

Bujar Nevzadi- i përshëndes të gjithë e posaçërisht kryetarin e Komunës, sepse sot ka gjetur kohë dhe është prezent në këtë seancë. Me siguri kryetari ka dëgjuar se sot nuk e kemi pasur ndërmend të jemi prezent për pa qenë edhe kryetari. I kam disa pyetje për kryetarin;

- Pse shpallja e konkursit nga ana e DKA-së po ndodh tash, për 50 vende për të cilët ka qenë deshtë të shpallet në gusht?
- Çka po ndodh me rrugën ku e ka shtëpinë kryetari, ai trotuar ka qenë i rregulluar njëherë, por përsëri edhe njëherë po rinovohet ai trotuar?
- Të na jap sqarime kryetari pas tre muajve që ka deklaruar se dikush i ka dëmtuar veturat e Komunës, konkretisht gomat dhe tash të na jep sqarime se kush i ka bërë këto gjëra të shëmtuara?
- Çka po ndodh me Shtëpinë e Kulturës në Përlepnicë, sepse para dy vite ka filluar renovimi, por qe dy vite janë ndërprerë punimet dhe tash përsëri ka filluar të dëmtohet?
- Të na njoftoni me një konflikt që ka ndodhur në mes të drejtorit të Prokurimit dhe inspektorit të Komunës?

Nevzad Isufi- i përshëndes të gjithë e posaçërisht aktorët të cilët janë në këtë sallë e të cilët në vend se të jenë në Teatër, vështirësitë për punët e tyre i kanë sjell në Kuvend edhe atë për të dytën herë gjatë këtij viti. Unë do të pyes përkitazi me rendin e punës, sepse sa herë po ndodh që të propozohet ndonjë pikë e rendit të punës nga opozita edhe pse e futni në rend të punës, nuk e sillni asnjë material! Sot i kemi tri pikë të rendit të punës për të cilat nuk e kemi asnjë material dhe as një fjalë të vetme të shkruar! Çka i thonë kësaj, injorim total i opozitës?! Nuk keni ofruar asnjë material, as ato që ia keni ofruar portaleve të ndryshme. Shtrohet pyetja se si do të shqyrtohen këto pika të rendit të punës për pa e pasur asnjë fjalë të shkruar?

Kjo nuk është rasti i parë që po ndodh, sepse kështu ka ndodhur në seancën e kaluar për çështjen e Arsimit, e keni fut në rend të punës për pa e ofruar asnjë material të shkruar. Ne po bëjmë pyetje se a është kjo kundër Rregullores së Kuvendit dhe a duhet të ndodh kështu?

Mandej kam një pyetje për kryetarin e Komunës: “a iu është ndërprerë marrëdhënia e punës shefit të Kabinetit të kryetarit i cili nga puna ka munguar 4 muaj, kurse tash është kthyer në Punë”?

Më konkretë gjatë muajve që ka munguar a ka marrë të ardhura personale?

Pyetje për Zyrën Ligjore: “ Çka ka ndërmarrë Komuna për kompensim të tokës të afër 82 pronarëve e cila është marrë për hapje të rrugës qarkore në sipërfaqe prej 13 hektarë, kur është bërë eksproprijim më 1998”. Sipas të dhënave tona vlera e këtij kompensimi është afër 30 milion €. A ka ndonjë përpjekje për ta bërë këtë kompensim”?

Kam edhe një pyetje për DKA-në, sepse për personelin arsimor nuk janë shpallur konkurse, por personeli është pranuar me kontratë në vepër i cili veprim është i kundërligjshëm! Si keni mundur ta lejoni pagesën e këtij personeli duke ditur se ky veprim është i kundërligjshëm dhe paraqet keqpërdorim të detyrës zyrtare! Gjithashtu edhe komisioni për Statut në vitin 2014 njëra ndër vërejtjet ishte mos regjistrimi të asteve komunale, sepse nuk janë regjistruar asetet komunale për 15 vjet, prandaj pyetje për drejtorin e Financave është se cilat janë arsyeje për mos hartimin e këtij regjistri?

Pyetje për Komitetin për Riatdhesim dhe Kthim: “pse ky Komitet edhe pse kanë kaluar dy vite asnjë çështje nuk e ka shtruar ose rekomanduar për debat asnjë çështje në Kuvend”?

Riad Rashiti- i kam dy çështje për t’i debatuar: e para ia uroj kthimin Arbër Ismailit në vendin e

punës duke dëshiruar që kthimi i tij të jetë në dobi të punës së kryetarit të Komunës!

Mirëpo kam pyetje për kryetarin e Komunës se a e cilëson si antiligjore kthimin e tij pas 5 muajve në vendin e punës për të cilën kohë ka marrë edhe pagë? Kjo është një keqpërdorim i hapur i buxhetit të Komunës. Në anën tjetër kemi shumë aktorë të Teatrit të cilët nuk kanë marrë pagë edhe pse kanë kontratë për vend të punës! Për këtë rast unë pyes se ky veprim a është i kundërligjshëm dhe a është keqpërdorim flagrant i buxhetit të Komunës?

Shqetësimi i dytë është sepse vazhdimisht shkelet Statuti dhe Rregullorja e punës së Kuvendit, sepse ne adresojmë shkresa të ndryshme me shkrim duke kërkuar përgjigje, por përgjigje marrim shumë pak! Nga kryetari i Komunës as vitin e kaluar as këtë vit asnjë përgjigje nuk e kemi marrë! Shumë shqetësuese është edhe mosmarrja e përgjigjeve nga DUMM, sepse i kemi bërë tri kërkesa me shkrim e të cilat i kemi drejtuar për këtë seancë, por po shihet se asnjë material nuk e kemi marrë lidhur me çështjet të cilat kemi bërë kërkesa. Pika e rendit të ditës për ndërtimet pa leje hynë pas një viti që kemi bërë kërkesa, por edhe pse ka hyrë kjo pikë në këtë seancë nuk e kemi asnjë rresht të vetëm, nuk e keni sjell si informacion. Ne kemi konsideruar se ka krim në aspektin urbanistik të Gjilanit dhe kjo fshehje dhe ky refuzim tregon hapur se ju jeni duke i kontribuar kësaj gjendje të kaosit të këtyre ndërtimeve në Gjilan.

Kërkoj përgjigje nga kryetari se a është e vërtetë se Komuna e Gjilanit e ka nënshkruar aktin e anëtarësimit të Komunës në Konventën e kryetarëve të KE-së. Unë kam kërkuar me shkrim përgjigje dhe kam kërkuar kopje të dokumentit dhe nëse nuk është bërë ky anëtarësim, kjo është shumë shqetësuese!? Gjithashtu e keni keqpërdor dhe po vazhdoni ta keqpërdorni raportin e Auditorit të Përgjithshëm, sepse juve kryetar iu kërkon saktë nisjen e hetimeve për një rast!

Nuk është raport për t' mburrur, nuk është e moralshme etike dhe shoqërore që të thirrreni në të pavërteta. Të gjitha gjërat haptas ia u tha edhe KDI dhe Agjensioni i Antikorrupsionit, prandaj kërkojmë përgjigje për të gjitha pyetjet që i bëra?

Avdyl Aliu- në secilën seancë e kemi nga një urim, por urimi im në këtë seancë në emër të LDK-së është urim njerëzor dhe patriotik, sepse ende po ndiej atmosferën festive të nëntorit.

Në emër të grupit të LDK-së dhe në emër të gjithë atyre që dëshirojnë të jenë pjesëmarrës në këtë urim ia uroj festat e Nëntorit të gjithëve, por posaçërisht disa kolegëve tanë e të cilët kanë pasur dëshirë të jenë të pranishëm në këto ditë feste e që kanë munguar në agjendën e Komunës për festat e nëntorit. Më vejnë shumë mirë që menjëherë dolën në shesh fjalët që i thash para kësaj seanca sa i përket sallës së KK-së, sepse dikujt iu duk e vogël kjo sallë. Edhe pse dikujt iu duk e vogël në këtë sallë ne do të kryejmë punë të mëdha në sallë të vogël. Mirë që dikujt i dukën të "Vogla" këto mure, por unë në këto mure të "vogla" e shoh një pjesë të historisë së qytetit të Gjilanit. Po them një pjesë, sepse për ta shkruar tërë historinë do të duhen shumë salla, me shumë mure më të mëdha se këto. Historia e Komunës së Gjilanit sa është e dhimbshme, aq më tepër është edhe krenare. Kjo sallë e vogël në këto ditë të festave të Nëntorit priti njerëz të mëdhenj dhe shërbeu për punë të mëdha! Jam krenar për punët që po kryhen në këtë sallë, sidomos këtyre ditëve.

Kryetari e ka thënë, por edhe unë po e them se asnjëherë nuk mund t' i dalim hakësh dëshmorëve të rënë për liri nëpër vite. Mirëpo ne jemi në rrugë të mirë dhe janë për admirim iniciativat e kryetarit për emërtimet e shkollave me emrat e Dëshmorëve dhe për të vazhduar edhe me emërtimet e rrugëve nëpër fshatra dhe qytete. Mandej dhënia e çmimit qytetar-e, nderi për zonjën Hanife Malaj dhe z. Rexhep Berisha. Mirëpo nuk duhet harruar edhe inaugurimin e Kompleksit të Varrezave, prandaj vazhdojmë me punë të mëdha në këtë sallë të vogël.

Sa i përket rendit të ditës ne jemi marrë vesh në KPF dhe ne pajtohemi me këtë rend të ditës.

Arijetë Rexhepi – po e shfrytëzoj rastin t' i bëj disa pyetje të cilat shumë shpesh po i përsërisim dhe nuk po marrim përgjigje? Për Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit kam pyetje se çfarë masa po merren për pronat e uzurpuara dhe në parandalim të kësaj dukurie negative? Më konkretisht të na njoftoni sa lëndë janë dërguar në Gjykatë për uzurpim të pronës dhe lëndë të kësaj natyre janë proceduar në këtë drejtori?

Për DUMM kam pyetje se deri kur ka arrit Komisioni për emërtimin e rrugëve në Komunën tonë dhe në emër të grupit të LVV, kjo drejtori të dërgojë për shqyrtim raportin për realizmin e Planit zhvillimor urban për vitin 2008-2015.

Një pyetje për drejtorin e Arsimit, sepse kemi qenë të njoftuar se në Shkollën Filllore “Sadullah Brestovci” do të hapet një paralele për nxënësit me autizëm. Pse nuk është hapur kjo paralele e cila është shumë e nevojshme për këta fëmijë?

Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike si është e lidhur kontrata me marketin “Wiva” afër Postës së Vogël dhe kur do të fillojë transporti urban i shumëfolur në Komunën tonë?

Në shumë rrugë të qytetit tonë ende nuk ka ndriçim publik dhe ato rrugë janë të degraduara dhe plotë baltë, prandaj përveç baltës dhe gropave çka keni ndërmarrë për eliminimin e qenve endacak?

Shukrie Rapuca- para se ta ngris një shqetësim, mua po më duket se kjo seancë po i përngjan orës letrare dhe dua ta di se a jemi në orë letrare apo në seancë të Kuvendit?

Shqetësimi im ka të bëjë me atë të qytetarëve, sepse po bëhen ndërtime dhe meremetime të trotuareve të rrugëve dhe ai pak gjelbërim që ka qenë në qeverisjen tonë ka filluar të dëmtohet.

Nuk është vështirë për askënd që ata drunj të cilët nxirren gjatë meremetimit të trotuarëve, ata drunj të mbillen përsëri. Ata drunj lihen ashtu të nxjerrë me javë të tëra dhe nuk mbillen më!

Kërkoj një përgjigje pse po bëhet kjo neglizhencë dhe papërgjegjësi?

Bjaram Hasani- unë duke i parë zhvillimet në Kosovë në përgjithësi, ne nuk mund të rrimë këtu indiferent dhe të bëhemi se gjëja nuk po dimë asgjë? Ne si opozitë e bashkuar në nivelin qendror kemi ngrit një kauzë të drejtë dhe ajo është çështje e komunave serbe ose “Zajednica” dhe demarkacioni me Malin e Zi. Unë kërkoj sot që t' i ngrisim këto dy çështje për diskutim sa për të pasur njohuri edhe anëtarët e Kuvendit së çka po ndodh, por edhe qytetarët e Anamoravës, sepse ne e dimë se Anamorava preket më së shumti nga kjo “Zajdnë” dhe nga ky copëtim i tokave tona. Unë kërkoj që këto dy çështje të debatohen si pikë e rendit të punës për ta kuptuar se çka është kjo “Zajednicë” dhe ky demarkacion? Në të kundërtën ne i kemi votat për ta ngritur edhe në seancë të jashtëzakonshme, por për mos ta debatuar në seancë të jashtëzakonshme unë kërkoj që të jetë pikë e rendit të punës?

Bujar Nevzadi-unë e kam një replikë me shefin e grupit të LDK-së, sepse në seancën e kaluar e kam ngrit çështjen e kësaj salle të Kuvendit, sepse e kam thënë se ne e kemi pasur sallën më të mirë në nivel të Kosovës dhe kam bërë pyetje pse është ndërruar? Unë kam thënë se është e ngushtë, por edhe sot po them se është e ngushtë dhe shefi i juaj nuk po sheh se është e ngushtë! Po sheh njerëzit që po rrinë në këmbë dhe prapë nuk pajtohet ! Unë kërkoj për ta ditur pse është ndërruar salla e Kuvendit?

Fehmi Sylejmani- kam pyetje për kryetrim, por ndoshta mund të përgjigjet edhe drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim se cilat janë masat që janë ndërmarrë për rritjen e numrit të zjarrfikësve profesional, sepse numri i këtyre zjarrfikësve është i pamjaftueshëm? Cilat janë raportet aktuale të Shërbimit të Zjarrfikësve me Agjensionin për Urgjencë në Prishtinë, kur dihet se një numër i Shërbimit të Zjarrfikësve është i punësuar me kontratë në vepër gjë që është në kundërshtim me ligjin. Një pyetje e kam për prokurimin, sepse që nga viti 2008, kur ka hyrë në fuqi Ligji VL

asnjëherë nuk është respektuar neni 52 i LVL-së i cili në mënyrë decitive e thotë se KPF është përgjegjës për shqyrtimin e Planit vjetor të prokurimit. Ne konsiderojmë se Plani komunal i prokurimit për pa u shqyrtuar në KPF dhe pa u aprovuar në KK nuk është valid dhe si tillë nuk mund të zbatohet !?

Po shfrytëzoj rastin për ta falënderuar drejtori për Bujqësi i cili ma ka kthyer një përgjigje me një volum të madh, por në ndërkohë do t' i kemi edhe disa pyetje sqaruese.

Procesverbali u aprovua pa vërejtje me 22 vota, 1 kundër, kurse tetë nuk votuan.

Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

2.1 Informatë për gjendjen në Teatrin e Gjilanit

Lutfi Haziri- me kërkesë të KPF-së dhe Bordit të Teatrit dhe me kërkesë të një grupi të aktorëve që e udhëheqin Sindikatën e Teatrit, ne kemi marrë veprime konkrete pas reagimit protestues që punëtorët e Teatrit e kanë pasur në zgjidhjen e problemit të tyre që quhen paga e nuk janë paga?

Ju e dini se me ligjet e Kosovës, lista e pagave është e definuar qartë, kurse sa i përket Teatrit ka pasur kontratë me Teatrin e që nuk është as kontratë në vepër, por është marrëdhënie kontraktuale e improvizuar në Ansambël të Teatrit dhe organe tjera përveç punëtorëve teknik që janë pjesë e stafit. Unë në fillim të mandati kam premtuar se në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës do ta zgjedh problemin e Teatrit, por problemi nuk është në Gjilan, por është në Qeveri. Suspendimi i një drejtori në të kaluarën dhe zgjedhja e drejtorit të ri, hartimi i Ligjit përkatës për Teatrot dhe ndërmarrja e veprimeve konkrete e ka dëmtuar Teatrin Profesional të Teatrit.

Kryetari foli mjaft gjatë për problemet në Teatër, por i rekomandoi Kuvendit që ta aprovojnë këtë rekomandim” Me propozimin e kryetarit të Komunës nga vija buxhetore e kryetarit të Komunës do të ndahen edhe 47 mijë € nëse ju i mbështetni dhe në të njëjtën kohë unë gjatë kësaj jave do të ndërmarrë veprime konkrete për të nënshkruar obligimet dhe për ta shpall konkursin në Teatër. Sipas një strukture dhe një riplanifikimi buxhetor Teatrit vitin e ardhshëm për repertuar dhe për shpenzime tjera i duhen 215 mijë €”. Kjo është minimale vetëm për ta garantuar punën dhe repertuarin sipas kërkesave. Unë jam i gatshëm edhe këto para për t' i ndarë e të cilat mjete do të ndahen me nën kod buxhetor. Mjetet do të barten në Teatër dhe do të menaxhohen nga zyrtarë të certifikuar, por këto mjete do të raportohen dhe do të auditohen si njësi e pavarur. Kjo është mënyra e vetme se si do të zgjidhet ky problem. Në vijim kryetari dha edhe sqarime më të hollësishme përkitazi me funksionim e Teatrit.

Sahit Abazi- më vjen mirë që është marrë seriozisht nga ana e kryetarit problemi i Teatrit, por është keq se ky seriozitet po vije pas protestave. Nëse pas çdo proteste do të gjejmë zgjidhje, kjo është keq! Megjithatë nuk ndihem mirë, sepse ne njerëzit që merremi me politikë duhet të merremi edhe me Teatër. Realisht ne me Teatër ka qenë deshtë të merremi vetëm si spektator dhe në asnjë variant tjetër për këto tema që po diskutojmë tash. Problemi është banal, sepse njerëzit kanë mbetur me muaj të tërë pa paga, por ky propozim i kryetarit mund të jetë edhe lojë fjalësh, sepse marrëdhënie kontraktuale thuhet është pagë s' është pagë etj. E rëndësishme është se këta njerëz për nëntë muaj nuk kanë pasur të hyra për t' i mbajtur familjet e veta. Nëse mjafton kjo shumë e mjeteve që po sa e tha kryetari prej 47 mijë € deri në fund të vitit që të zgjidhet problemi i borxhit që Komuna ia ka aktorëve do të ishte mirë. Mirëpo kemi edhe diçka që kryetari nuk e tha, sepse edhe nëse seancat e tjera e ka thënë se është duke bërë përpjekje me Ministrinë për ta zgjidhur problemin e Teatrit e që do të ishte mirë po të zgjidhej, por ligji thotë se Komuna duhet t' i zgjidh problemet e Teatrit. Kjo zgjidhje me nën kod buxhetor që teatri të financohet është zgjidhje e mirë, sepse është drejtpërdrejtë zbatim i ligjit për Teatrin.

Gjithashtu duhet parë mundësinë që edhe objektet e teatrit ato përcjellëse aty ku është Drejtoria për Kulturë dhe objektet e tjera duhet të vihen në shërbim të Teatrit përmes së cilave do të gjeneroheshin mjete, sepse Teatri i Gjilanit është njëri ndër më të mirët në Kosovë. Si PDK ndihemi mirë sot që po realizohet një kërkesë dhe urojmë që të jetë serioze dhe do të votojmë për duke dëshiruar që më asnjëherë mos të merremi me Teatrin !

Shpresë Kurteshi- edhe më parë e kam theksuar, por edhe tash po e them se gjendja e rëndë në Teatër nuk është krijuar së voni, por kjo gjendje ka qenë edhe më herët. Mirëpo shqyrtimi dhe marrja me Teatrin nuk po vjen si kërkesë e opozitës, por pushteti i tanishëm dhe ne si Komitet i Kulturës në bashkëpunim me kryetarin e Komunës dhe me aktorët e Teatrit në vazhdimësi e kemi pasur temë të diskutimit nëpër takimet tona. Në takimet me Bordin kemi marrë një propozim nga kryetari i Komunës i cili sapo e propozoi para juve. Ne kemi pasur mjaft takime për këtë rast dhe për pa e zgjatur më shumë ne si grup i LDK-së e mbështesim propozimin e kryetarit për t' i ndarë 47 mijë € Teatrit.

Selami Xhemajli- realisht po plotësohen rekomandimet nga seanca e jashtëzakonshme e cila është mbajtur për Teatrin dhe ajo të cilën e tha parafolësja nga KPF. Ne si grup i AAK-së e mbështesim iniciativën e kryetarit për subvencionim e aktiviteteve në Teatër për këtë vit në shumë prej 47 mijë €, për këtë vit dhe formimin e nën kodit për përmbushen e aktiviteteve dhe sistemimit sipas përzgjedhjes me konkurs për një Teatër funksional.

Nevzad Isufi- nga seanca e jashtëzakonshme e cila është mbajtur në pranverë duket se nuk ka lëvizur asgjë, por sot po duket se nuk kemi se çka të themi shumë, por për aktorët një vit është i humbur, sepse në radhë të parë këta e kanë pasur çështjen e ekzistencës së tyre. Pas ekzistencë, atëherë mund të flitet për punë dhe kreativitet artistik në Teatrin e Gjilanit. Nga perimet nuk mund të jetojë askush dhe as nga temat e diskutimit, por këta do të kishin jetuar më dinjitetshëm po t' i kishin pasur pagat normale si të gjithë të tjerët. Premtimi i shumës për të ardhmen, nënkupton se po anashkalohet e kaluara dhe e tashmja. Ne po flasim për të ardhmen e cila është hipotetike dhe nuk duhet të flasim për riorganizimin e Teatrit, sepse ato janë çështje që i takojnë edhe anës ligjore.

Është fat i keq për Teatrot, sepse tash e 15 vjet ata po mbesin nën mëshirën e kryetarëve të komunave , prandaj edhe me këtë rast po ndodh kështu. Mirëpo ligjit për teatrot nuk vlen vetëm për Komunën tonë, por vlen për të gjitha komunat e Kosovës. Nëse teatrot e qyteteve tjera të Kosovës kanë pasur mundësi të gjejnë zgjidhje, atëherë pse nuk është gjetur zgjidhje për Teatrin e Gjilanit? Teatri i Gjilanit ka qenë një ndër teatrot më aktiv në nivel të Kosovës.

Unë jam për të përkrahur çdo zgjidhje që është e dinjitetshme dhe që është më afatgjate dhe jo ad-hok dhe për një kohë të shkurtër. Ne nuk kemi se si mos ta përkrahim këtë iniciativë, por me dëshirë që mos të mbesin vetëm fjalë, por të realizohet praktikisht.

Izmi Zeka- do të kisha pasur dëshirë për ta dëgjuar Nazim Gagicën, sepse është njeri i Kulturës dhe është marrë gjatë me kulturë dhe jo vetëm që i ka miq dhe shokë aktorët, por janë pjesë e tij dhe ai ndoshta ka qenë deshtë ta ngrit zërin shumë më shumë.

Unë po theksoj se Teatrin e kemi shndërruar në rast social, taman “teatër.” Është mjerimi më i madh (nuk po them i kësaj qeverie), por është mjerimi më i madh që të i biem këta njerëz këtu dhe politika të merret me ata. Politika t' ia përcaktojë rrogat, politika t' ia përcaktojë nesër konkursin se kush duhet të zgjidhet dhe kush është më profesional. Kjo është më e keqja që e kemi sjell veten në këtë pozitë dhe unë do të jap një propozim konkretë, sepse nuk ka material këtu u tha më parë, sa iu duhen mjete qoftë për repertuarin etj. Unë do të kërkoj që ato 47 mijë € nëse janë të mjaftueshme që sot të alokohen menjëherë dhe të kalojnë dhe mos të presim të kalojë një muaj deri në seancën tjetër.

Lutfi Haziri- moralizim dhe moral z. Zeka ju keni bërë tash. Nëse dikush dëshiron për ta parë definicionin e diskutimit me moral dhe moralizim për një çështje gjashtë vjet, prej të cilave 4 vjet keni qenë kryesuesi i Asamblesë Komunale dhe nuk e ka zgjidhur problemin është bukur shumë. I bie si shumë, sepse asgjë nuk ka ndryshuar në ligj dhe me të njëjtin ligj e kemi trajtuar problemin dhe me të njëjtin nen. Është degraduar në vitin 2008, Ligji për teatrin për një pozitë drejtori. A e zgjedh ministria drejtorin apo komuna dhe me këtë konflikt Komuna e Gjilanit i ka humbur 50% të subvencioneve për shkak të një pozite të drejtorit., sikurse teatri i Prizrenit dhe ai i Gjakovës.

Sot unë jam këtu dhe ka e ka nuhat dikush dhe ka ndërhyrë dikush me manipulim dhe i ka nxjerr kolegët para Komunës! Problemi ka qenë në zgjidhje, sepse e kanë ditur saktë se ne po punojmë me bord dhe komitet në bazë të vendimit të KK. Unë propozoj që 47 mijë €, sot të ndahen, sepse arka mbyllet edhe dy javë. Për vitin e ardhshëm buxhetor e thash se si do të zgjidhet çështja dhe e dini se kurrë Teatri nuk i ka pasur këto mjete dhe nëse ka mjete rritet buxheti, por jo mjete për të qëndruar nëpër kafiteri, por mjete për të punuar në Teatër. Këta njerëz me pak aktorë duhet të japin shfaqje të mira dhe duhet të ketë repriza, sepse shfaqja që epet njëherë ajo vdes.

I njëjtë është edhe problemi i zjarrfikësve, por edhe ky problem është i trashëguar, ne nuk paguajmë mjete me kontratë në vepër për zjarrfikësit. pagesën e bën Shoqata e Vullnetarëve të Zjarrfikësve dhe ata janë 9 zjarrfikës që janë gjetur në Komunë dhe vazhdojnë për të punuar në bazë të një marrëveshje që është bërë në Komunë dhe paguhen si shoqatë e zjarrfikësve.

Bujar Nevzadi- ne së bashku me kryetarin e Komunës dhe me aktorët e Teatrit së bashku jemi rritur, 10 vjet në Shtëpinë e Kulturës në Përpelnicë në të cilën shtëpi aktorët kanë punuar në kushte jo normale. Mirëpo ajo Shtëpi e Kulturës nuk po ndërtohet edhe sot, sepse është harruar.

Mirëpo të njëjtat fjalë i ka pas thënë edhe ish kryeshefi se gjithë aktorët por rrinë në kafiteri dhe po i rrisin flokët dhe nuk i ndante subvencione, por të njëjtat fjalë kryetari i Komunës po e thotë sot.

Kryetari kur po pret sportistët dhe aktorët e mirë po krenohet ma ata, kurse sot del e thotë të kundërtën! Unë jam një shikues i rregullt i shfaqjeve teatrore dhe jemi mburrë me Teatrin. Është “Fala e Janarit” nëntë muaj punëtorët nuk kanë marrë paga, kurse “Flakën e Janarit” do ta hapim ne si do të kërkojmë prej aktorëve kur 9 muaj nuk i kemi dhënë pagë? Është mirë që ndonjë aktorë që është i pranishëm të del në foltore dhe të na e sqaroj situatën se çka po ndodh në Teatër?

Lutfi Haziri- nuk kam nevojë të polemizoj, sepse kemi punuar bashkë edhe gjatë okupimit dhe pas okupimit, por me kohë do të vlerësohet kush çka dhe sa ka punuar? Teatri nuk ka asnjë kualifikim tjetër pos Teatri i Gjilanit. Edhe në historikun e mëparshëm edhe në historikun më të ri, e ka krenarinë e vetë, i ka rezultatet e veta dhe ato nuk ja kemi dhënë ne, por ata i kanë fituar, kurse ne i kemi ndihmuar aq sa kemi pasur mundësi. 100 mijë € janë ndarë për teatrin, Qeveria 97 mijë dhe 10% pjesëmarrje e Komunës për renovim të Teatrit këtë vit.

Edhe sa i përket Shtëpisë së Kulturës dhe Kodra Dëshmorëve e kanë një fat të përbashkët, sepse të dyja kanë mbetur për moskujdes! Mua më ka rra hise për t’i hap varrezat, por kam qenë njeri më i turpëruar në Gjilan, por edhe më krenar në të njëjtën kohë!

Edhe Shtëpia e Kulturës në Përlepnice është shtëpi ku është rezistuar, por aty edhe pse kanë filluar punimet janë ndërprerë me vendim dhe nga organi mbikëqyrës është konstatuar se Shtëpia e Kulturës në Përlepnice ka filluar të ndërtohet pa projekt detal! Ka filluar vetëm me projekt ideor dhe ka qenë e domosdoshme për ta bërë prerjen, revidimin dhe për ta hartuar projektin detal për ta filluar procesin e rindërtimit. Pas kompletimit të komplet dosjes ne mund ta renovojmë dhe z. Nevzadi dhe do të bindet se si është punuar! Ne jemi duke e kompletuar dokumentacion dhe ajo do të realizohet ashtu si është realizuar projekti i Varrezave të Dëshmorëve.

Izmi Zeka- unë kërkoja që aktorët ta marrin fjalën, por jua prapë mos ia jepni. Kryetari i Komunës më tha se gjëja unë paskam bërë moral, mirëpo unë jam ithtar i veprimeve konkrete, kurse kryetari bën politika të mëdha, politika globale, sepse janë të rënda politikat lokale. E di që e ka pak rëndë të merret, por është zgjedh kryetar i Komunës dhe le t' i bëjnë punët si duhet. Ka shumë probleme Gjilani dhe nuk dua të merrem shumë gjatë me këto, sepse po merren kolegët e mi këtu dhe po preken gjendjet më kruciale. Mirë që i keni rregulluar Varrezat e Dëshmorëve, nuk është rregulluar sot, rregullohen nesër, sepse këto varreza janë të gjithëve. Sot e ke pushtetin z. Kryetar e ke cilën të duash ministri dhe deri dje na ke torturuar duke thënë po vijnë jabaxhinjtë, por sot po vjen Isa Mustafa dhe i thua që t' i zgjidhin problemet në Gjilan.

Riad Rashiti- sa i përket debatit për këtë pikë unë nuk po shoh seriozitet aspak nga kryetari i Komunës, por as nga ju! Rendi i punës është: informatë për gjendjen në Teatër dhe nuk e kam të qartë se a e din kryesuesja se informata nuk votohet? E dyta po propozoni vendim për ndarje buxhetore për 47 mijë €. Ku ka dokument sot që na ka ardhur si vendim? E dyta po thoni Teatri vitin e ardhshëm do ta ketë nën kodin buxhetor dhe do t' ketë 2015 mijë €. A keni harruar apo nuk jeni duke e ditur? Buxheti i Komunës së Gjilanit është miratuar për vitin 2016 dhe nuk keni mundësi ju sot t' i ndani 2015 mijë € për Teatrin, sepse nuk ka të drejtë? Është drejtori i Financave le ta thotë se a ka të drejtë? Nuk ka asnjë rresht të shkruar se nga cili kod po rrjedhin këto mjete?

Bajram Hasani- unë sa e pashë këtu dhe sa vërejta ekziston një frikë pse nuk iu kanë dhënë pagat aktorëve! A po dalin nëpër kafiteri apo jo, kjo nuk ka rëndësi, por ekziston dyshimi se këta aktorë nuk po bëjnë punën si duhet? Unë kërkoj nga kryetari i Komunës që në kohë të pauzës të hartohet vendimi dhe le të respektohet ligji. Të bëhet kjo për mos u shtyrë pagesa edhe për dy muaj. Kërkoj nga kryetari i Komunës t' ia bëjë pagesën, por ta kërkojë edhe punë, por edhe t' i epet mundësia edhe aktorëve për ta marrë fjalën.

Leonorë Bunjaku- nuk qëndron ajo që po e thotë kryesuesja se gjëja pa kërkesë me shkrim nuk mund të merret fjala, sepse njerëzit kanë ardhur nga rruga dhe e kanë marrë fjalën në këtë Kuvend, prandaj ju lus të keni konsideratë dhe t' epet fjala edhe aktorëve të Teatrit.

Lutfi Haziri- për formalitet nuk duhet ta bëjmë asnjë vonesë, ky Kuvend është vendimmarrës dhe për këtë unë e kam marrë iniciativën dhe përgjegjësinë. Ju votoni, kurse sot pas dite fillojnë procedurat e pagesës, sepse mjetet janë të ndara nga vija e buxhetit të kryetarit të Komunës. Unë do t' i shpenzoj mjete e mia për Teatër dhe nuk po kapitalizoj asgjë, por vetëm jam duke e zgjidhur një problem.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkoi që të aprovohet iniciativa e Kryetarit për ndarje 47 mijë € subvencion për paga të aktorëve të Teatrit.

Aprovohet propozimi që për Teatrin të ndahen 47 mijë € si subvencion për këtë vit buxhetor nga Zyra e Kryetarit për pagesë të aktorëve të Teatrit, me 22 vota për, nuk ka abstenime as kundër, kurse 11 nuk votuan.

Në ora 11.45 deri në ora 14 të gjithë anëtarët e Kuvendit shkojnë në pushim për të marrë pjesë në varrimin e prof. Nuhi Ismailit.

Seanca i fillon punimet në ora 14.10 minuta dhe nga ana e sekretarisë u konstatua se në pjesën e dytë të seancë ishin prezent 28 anëtarë të Kuvendit, kurse 7 munguan.

2.2. Informatë rreth ndërtimeve në Komunën e Gjilanit

Valon Shefkiu- unë me kërkesën e opozitës do ta jap një informatë për ndërtimet në Komunën e Gjilanit, kurse Raportin e ka dorëzuar kryetari (për nëntë mujor). DUMM i a kryer punët e veta sipas dispozitave të ligjeve në fuqi dhe sipas rregulloreve komunale. Unë së pari po jap informatë nga Sektori i lejeve dhe në këtë drejtori gjatë këtij viti i kemi pasur 515 kërkesa, prej të cilave 444 kërkesa janë shqyrtuar, 188 kanë qenë për parcelim të trojeve, 87 kushte të ndërtimit dhe 107 leje të ndërtimit, janë refuzuar. Këtë vit e konsideromë se ka qenë një ndër vitet më të mira që nga fillimi, sepse shuma e pagesave për leje të ndërtimit është 661 mijë e 520 €, zbërthyer në m²110 mijë e 800m², por shndërruar në përqindje është 97% e planifikimit për vitin 2015.

Sektori i Inspektionit i cili tash vepron në kuadër të DUMM, ka kryer detyrat sipas ligjit si është rasti me hartimin e procesverbaleve, shiritim të objekteve dhe vendime për ndërprerje të punëve, vendime për rrënim të objekteve, gjoba mandatore dhe shqyrtim të ankesave dhe kërkesave të qytetarëve.

Inspektime në terren kanë qenë 521, procesverbale për ndërprerje të punëve kanë qenë 123, procesverbale për ndërprerje të punëve dhe shiritim të objekteve 45, vendime për rrënim të objekteve 45 dhe dënime mandatore 8 në vlerë prej 1.300.00 €.

Sa i përket sistemit të adresave, secila parti i ka përfaqësuesit e vetë, por sa kam njohuri unë në pjesën urbane 98% e punëve ka përfunduar, kurse pjesa rurale është afër 70-80% dhe është në përfundim e sipër.

Drejtori i DUMM i tha edhe disa hollësi të tjera, por raporti më detal për ndërtimet në Komunën e Gjilanit gjenden në raportin e kryetarit të Komunes për punën nëntë mujore të vitit 2015.

Riad Rashiti- së pari ne si grup i PDK-së e kemi vërejtjen e parë për mungesë të materialit për këtë temë, sepse është ditur se që një kohë të gjatë kjo pikë është kërkuar nga ne dhe është deshtë të dërgohet një material dhe jo drejtori t' i lexojë këtu disa shifra e të cilat janë të gjitha shkel e shko!

Sa i përket të hyrave fare nuk ka logjikë të krahasohet sasia e ndërtimit të këtij viti me vitet e tjera dhe niveli i të hyrave është jashtëzakonisht i ulët. Nuk është mirë të shpifin gjëra këtu nga drejtori, sepse unë e posedoj vulën kur është bërë kjo informatë dhe aty shihet se është me 30.11.2015 do të thotë sot është dërguar në parti. Është mirë të tregohet kush ka ndërtime pa leje këtu dhe le të thuhet me emër!?

Te legalizimi keni dështuar plotësisht, sepse nuk i keni njoftuar qytetarët ashtu si duhet, bile as ne nuk jemi njoftuar ashtu si duhet. Ne ka një vit që kemi kërkuar për të biseduar për këtë çështje, por ju nuk e keni fut në rend të ditës, sepse po shihet se keni frikë për të debatuar për këtë dukuri shkatërruese në qytetin e Gjilanit. Ne vlerësojmë se kjo gjendje nuk ka ardhur rastësisht dhe nga mosdija e juaj, sepse ju jeni ekspert, por edhe ke qenë inspektor edhe gjatë qeverisjes sonë dhe ke mundësi për të dhënë sqarime për disa probleme të cilat kanë ndodhur edhe më parë, por ju nuk e keni kryer obligimin e juaj dhe ju e keni një dosje ku shihet se keni qenë në Komision disiplinor, sepse nuk i keni kryer detyrat sipas ligjit.

Është mirë që të dihet se çka keni bërë ju edhe në qeverisjen tonë dhe jo vetëm tash?

Ne kemi mundësi për ta argumentuar se ju keni bërë plan dhe kjo gjendje ka ardhur si rezultat i një plani të biznesit të kësaj qeverisje për të përfituar shumë milion € nga ndërtimet totalisht të pakontrolluara.

Këto dukuri shkatërruese kanë ardhur sikur mos të ketë shtet, ligj, nuk ka inspeksion, nuk urbanizëm dhe nuk ka as kryetar Komune. Ky "planifikim" ka filluar të zbatohet, atëherë kur është shuar Drejtoria e Inspektionit. Mandej kjo avari ka vazhduar me ndryshimin e disa planeve urbanistike në qytet e të cilat ende nuk janë aprovuar, por ndërtimet kanë përfunduar. Kaosi urbanistikë është planifikuar aq mirë nga ju dhe sot jeni duke e shkatërruar qytetin e Gjilanit!? Mandej ju e keni krijuar edhe një Komitet Konsultativ të Ekspertëve për Planifikim Hapësinor i cili komitet është i përbërë me 90% me Fakultet të Edukimit. Ky komitet i ashtuquajtur i ekspertëve nuk ka lidhje me planet urbanistike dhe nuk mund as t' i lexojë dhe nuk e dinë se çka janë planet urbanistike? Hapi më i keq tjetër është se kryetari i

Komunës e ka emëruar drejtor të DUMM një person i cili ka qenë në Komision disiplinor për mospunë për papërgjegjësi në kohën e qeverisjes së PDK-së. Tash në raportet e juaja zyrtare thuhet se janë mbi 120 ndërtime pa leje, kurse 86 vendime i keni marrë zyrtarisht për rrënim, por ka shumë ndërtime të tjera që nuk i ka kontrolluar dhe nuk i keni lëshuar asnjë vendim. Janë lëshuar 86 vendime për rrënim, por asnjë nuk ka ndodhur, sepse edhe një pjesë të planit e keni realizuar, sepse e keni kontraktuar një kompani për rrënim nga Kaçaniku, por e cila kompani asnjëherë nuk ka ardhur në Gjilan. Kjo është strategia e juaj për t' i mundësuar një strukture po them lirisht kriminale urbanistike e cila po e dhunon Gjilanin.

Dihet shumë mirë se kush janë ata zyrtarë dhe kush qëndron prapa këtij biznesi. Nëse nuk qëndron kjo, atëherë është mirë të na e argumentoni pse deri më sot asnjë veprim nuk është ndërmarrë? Janë edhe tri raste të uzurpimit ku janë bërë ndërtime pa leje, ne i kemi identifikuar, dy janë në qendër të qyteti, kurse një në Rugën e Prishtinës. Ato janë ndërtime pa leje, janë ndërtuar në këtë qeverisje dhe ka uzurpim të pronës publike! Për të gjitha këto dikush duhet të mbajë përgjegjësi dhe së pari drejtori, pastaj kryetari, sepse kryetari është përgjegjës për t' i kontrolluar drejtorët.

Bujar Nevzadi- për gjendjen e krijuar në Gjilan në fushën e ndërtimeve me orë të tëra kemi material për të folur që nga fillimi kësaj qeverisje. Drejtori i tha disa fjalë kalimthi e të cilat nuk pata mundësi as t' i regjistroj i cili e ka bërë me qëllim të caktuar, por ne gjendjen në terren e dimë.

Drejtori nuk e tha asnjë fjalë sa ndërtime janë pa leje dhe kush janë ata dhe kush ka ndërtuar pa leje?

Kryetari i Komunës i ka emëruar tre njerëz në krye të kësaj pune për të cilët ka pasur informata e sidomos për drejtorin e DUMM se e ka keqpërdor detyrën në qeverisjen e PDK-së. E dyta unë sot e mora vesh se edhe shtëpinë e paska pa leje. Gjithashtu kryetari e ka emëruar edhe shefin e Inspektionit i cili e ka vendimin për ndërtimet pa leje dhe ajo çka është më rëndë e ka bërë një shef të grupit parlamentar të LDK-së i cili është kulmi keqpërdorimeve në Komunë të Gjilanit. Unë i kam këtu, objekti nr. 1- "Agro-hermes" tejkalim 1.5 kate, objekti nr.2. 764m² pa leje, objekti nr. 3 është i vetmi njeri i cili e ka ngrit dy kat më tepër, por edhe për objektin tjetër të cilin tash e ka filluar kam dëgjuar se nuk ka marrë leje. Me vendosjen e njerëzve të papërgjegjshëm në krye të institucioneve jam i mendimit se më së tepërmi do t' i hakmerret kryetarit. Ne e kemi edhe një shkresë nga Prokuroria se Drejtoria e Inspektionit është nën hetime dhe besoj do të zbardhen shumë dukuri negative.

Unë kam propozuar në një debat me "Lëvizjen Fol" që të formohet një komision për rastet e ndërtimeve pa leje, me të cilin propozim është pajtuar kryesuesja dhe po shpresoj se do të përkrahet dhe formohet një komision i tillë e të cilin do ta udhëheq opozita. Kështu me këtë komision do të dalim në terren dhe t' i faktojmë gjërat dhe nëse nuk qëndrojnë këto që po i themi, unë do të kërkoj falje, por nëse është e kundërta, atëherë duhet të jepni përgjegjësi dhe të japin dorëheqje personat përgjegjës.

Avdyl Aliu – para disa jave nuk është shumë larg ajo kohë, kur pata dal para jush me një grumbull dokumente, sepse unë jam adhures i dokumenteve dhe kam dokumente shumë. Nëse iu kujtohet e pata thënë se po e bëj këtë jo për ta pastruar veten, sepse i pastër jam, por për ta pastruar ndërgjegjen e disa kolegëve e që janë pak (dy). Unë atëherë me dokumente e sqarova dhe i këshillova këta koleg, sepse këta vazhdimisht dezinformonin opinionin. Unë atëherë i pata sjell dokument e lëshuara nga Republika e Kosovës nëse i besoni, por ju nëse kërkonit të tjera mund ta kaloni kufirin, Serbia nuk është larg në Nish apo Vrajë, ndoshta janë më të besueshme për juve. Unë i kam sjell të tërë dokumentacion dhe ju i keni parë, por me keqardhje prapë po dëshironi të merremi me këtë temë. Ky koleg po e keqpërdor pozitën e tij dhe po e keqpërdor votën e qytetarëve, sepse ata ia kanë dhënë votën për të punuar për ata dhe jo për t' u marrë me intriga dhe dezinformata. Në zgjedhjet e 2009, unë i kam pasur mbi 500 vota, por me punën time dhe me përfaqësimin e atyre votuesve më 2013 i kam 900 vota. Shtrohet pyetja ai i kisha marrë këto vota po të kisha gënjyer dhe keqpërdor pushtetin? Gjendja e kolegëve dezinformues në këtë aspekt është për keqardhje të madhe, sepse në më shumë se në 20 media informative ky

dezinformues jep dezinformata për ndërtimet në Gjilan, publikon fotografi të objekteve se gjëja janë të ndërtuara pa leje, por në mesin e atyre fotove ka shumë objekte të tilla që janë pajisur me leje, por këta ndërtues edhe i quajnë ndërtuesi kriminel, mafi e çka jo tjetër. Unë nuk e njoh për kriminel dhe mafioz asnjë ndërtues në Gjilan, por i njohë për njerëz të ndershëm të cilët kanë investuar dhe investojnë me punë dhe djersën e tyre dhe në pronat e tyre duke hapur çdo ditë vende të punës, prandaj ata nuk janë kriminel, por unë i quaj patriot.

Në mesin e fotove është edhe objekti “Agro-hermes 3” gjëja se nuk ka leje. Unë jam tmerruar kur e pash dhe nuk e di si mund të dezinformojë dikush aq rëndë? Z. Aliu e ekspozon lejen ndërtimore e të objektit e lëshuar nga DUMM në Gjilan e cila ka qenë në foto nga opozita gjëja si objekt pa leje.

Nuk është vetëm objekti i im që është në këto foto, por ka edhe objekte të tjera të cilat janë pajisur me leje ndërtimore e që kolegu dezinformon. Si nuk mendon ky koleq se dikush mund ta padis për shpifje dhe çfarë kënaqësie ndien që të merret me shpifje dhe intriga?

Në vijim të fjalës së tij, z. Aliu dhe sqarime lidhur me privatizimin e Fabrikës së Bukës “Kualiteti” dhe ndërtimeve të larta afër atij objekti.

Unë kërkoj nga të gjithë kolegët që ta përkrahim ndërtimin në Gjilan, t’i lehtësojmë procedurat për ndërtime, të kryejmë planifikimin sa më shpejtë, sepse ndërtimet janë fabrikat më të mira për punëtorë.

E falënderoj drejtorin për informatën e saktë dhe të mirë, sepse shumë çështje na i ka bërë të qarta.

Bujar Nevzadi- është për keqardhje çka po e thotë z. Aliu, sepse ky po e mbron veten, sepse asnjë fjalë nuk e tha për të tjerë, por vetëm për veten. Asnjë nga kolegët që janë prapa këtij zotëria nuk e përkrah për këto gjëra që i ka bërë. Ne nuk thamë që nuk i përkrahim ndërtimet, por thamë se i përkrahim ndërtimet me leje dhe me plan. Shefi Inspeksionit z. Avdyli ka dalë e ka shirituar objektin, por ti ke dalë dhe i ke shkaputur! Cili është shembulli i yt i mirë si shef i grupit të LDK-së. Ti në vend se t’i ndihmosh ata inspektorë, ti ke dalë vetë i ke shkaputur shiritat, këtë e dinë i gjithë Gjilani. Ne kemi kërkuar seancë të jashtëzakonshme për ndërtime, por për ndërtime me plan dhe me leje.

I vetmi Avdyli e ka tejkaluar planin zhvillimor të Komunës, sepse e ka ndërtuar objektin dy kat më lartë se sa ka qenë leja në atë pjesë.

Lutfi Haziri- ne duke e shqyrtuar një çështje të Komunës së Gjilanit e cila ka impakt, ka zhvillime nëse zgjidhet në përputhje me ligjin dhe nuk zgjidhet me piskama, as me denoncime. Drejtori e ka shpërndarë si informacion, por në raportin tim prej faqes 18-26 i keni të gjitha të dhënat që drejtori i Urbanizmit i ka paraqitur duke i përfshirë numrin e ndërtimeve ilegale të cilat i kemi gjetë dhe e kemi shtuar edhe ndërtimet legale të cilat kanë ndodhur. Kaq është ajo që duhet të themi, por nëse dëshirojmë të tregojmë ajo se çka ka ndodhur në mandatin dyvjeçar nuk është në rregull.

Nën dy do të ketë veprime konkrete në përputhje me ligjin, të gjitha ato objekte që kanë problem me ligjin, sikurse e ka problem “Fidanishtja”, sepse është bërë revidim jashtë ligjit dhe ekziston vendimi i Qeverisë së Kosovës mbi jo ligjshmërinë dhe mënyrën e ndërtimit në atë lokacion. Fidanishtja si proces do të trajtohet duke ruajtur çdo centimetër të pronës publike në Komunë të Gjilanit.

Klientalizëm nëse quhen ndërtuesit në Gjilan, është lista e ndërtuesve në Gjilan dhe që po vazhdojnë për të punuar në Gjilan dhe asnjë ndërmarrje e re nuk ka ardhur për të ndërtuar në Gjilan. Gjithçka që është duke u punuar po punohet në përputhje me plane dhe aktualisht jemi duke i hapur trasat në Fidanishten II dhe të “Livadhet e Arapit” dhe po i inkurajojmë bizneset për t’i bërë planet rregullative.

Ne nuk ndërhyjmë në zgjedhjen e investitorëve, sepse toka është private nuk kemi drejtë me ligj, ne kemi të drejtë të ndërhyjmë në kushtet e ndërtimit dhe kushteve tjera. Sa i përket Fabrikës së Bukës është pronë private dhe kjo fabrikë nuk ka asnjë lloj obligimi ndaj shtetit. Ai e ka privatizuar dhe e ka gjetë mënyrën se si të investojë. Kemi bërë ndërhyrje për ata që e kanë prerë shiritin (për ndërtim pa leje) do të ketë denoncime dhe lënda është në gjyq dhe në rastin më të keq do të marrim veprime për rrëhim.

Fidanishtja do të trajtohet, sikur një objekt të cilin nuk po e përmendni, do të trajtohet objekti 10 kate barabar me atë 1 kat. Përfundimisht duhet të punojmë me një standard dhe standardi i vetëm është ligji.

Bujar Nevzadi- kryetar të falënderoj për këto që i tha dhe për tri herë sa ke qenë në seancë po i përmend 30 raste të denoncimit unë nuk do të kisha thënë që të mbyllet kjo dhe mos të ndalen ato denoncimet. Në emër të PDK-së po them çka të kesh dërgojë në organet kompetente. Po të kishit pasur me siguri i kishit dërguar. Nuk ma tha një emër unë ta thash me emër shefi i Inspeksionit, Shkodra mua më ka thënë i kam dërguar inspektorët tek “Agro-hermesi”për ta shirituar objektin, është bërë shiritimi, por ai zotëria i ka shkëput. E përmendet se është rrit shuma e mjeteve të inkasuara, por nuk e thatë sa shtëpi janë ndërtuar në këtë periudhë? Sa janë pa leje nuk e thatë asnjë fjalë? Kulturën e juve ne PDK, asnjëherë nuk jemi të interesuar për ta marrë. Ju e keni shkatërruar Dardaninë me një objekti, e keni shkatërruar pjesën karshi spitalit, gjithashtu edhe te Dheu u Bardhë. Nuk jemi kundër ndërtimeve, por jemi për ndërtime me plan dhe me leje.

Lutfi Haziri- sa për sqarim lëndët janë në prokurorinë e Krimeve të Rënda z. Nevzadi, ne nuk i kemi dërguar, nuk kemi nevojë t’ i dërgojmë, por neve na janë kërkuar nga organet e rendit, dosjet origjinal dhe jo kopjet. Pas intervistave ku janë përfshirë edhe anëtarë të Kuvendit është kërkuar dokumentacioni origjinal, prandaj nuk jemi ne denoncues, por janë qytetarët e Komunës së Gjilanit dhe në asnjë rast nuk jemi ne. Të mos keqkuptohemi unë e kam listën e të gjitha objekteve që janë në tretman për krime dhe listën e zyrtarëve dhe operatorëve përfutues që janë pjesë e hetimeve. Mirëpo nuk jam i detyruar të flas, sepse nuk jam i thirrur për atë punë, tjetërkush merret me këto gjëra. Unë po e konfirmoj edhe njëherë se asnjëherë nuk kam denoncuar as para luftës as pas luftës edhe pse është akt patriotik, por nuk merrem me atë punë, nuk ma lejon kultura familjare dhe nuk jam i edukuar dhe nuk jam i prirë për të shkuar diku për të treguar. Këtë duhet ta bëjnë qytetarët, sepse dy mijë € është vlera për çdo denoncim të bazuar të cilat mjete ne ia japim policisë, kurse policia i ndan mjetet për çdo qytetar që lajmëron ndonjë rast për abuzim me leje dhe keqpërdorime tjetër.

Avdyl Aliu- prej tri investimeve në këtë biznes të investimeve që i kam bëri deri më tash, dy janë bërë në kohën e qeverisjes së PDK-së dhe një në të LDK-së. Në kohën e qeverisjes së PDK-së kur e kam filluar një objekt te “Jugu -1”, në prezencën e ish kryetarit z. Bujari më ka pyet se gjëja kë e kam korruptuar që e kam marrë lejen në këtë vend? Unë jam përgjigjur se nëse Komuna ka marrë korrupsion, mbani në mend se ky është rasti i parë që Komuna ka dhënë leje për pa u korruptuar, sepse kurrë nuk jam korruptuar as atëherë dhe as tash. Ato dy objekte, janë ndërtuar me leje ka pasur plan rregullues aty dhe çdo gjë është sipas ligjit. Po i them grupit të PDK-së, se qeverisja e Gjilanit ka një qeverisje shumë demokratike, më vjen mirë për kulturën demokratike që e kemi në platformën tonë politike të qeverisjes. Puna në të gjitha drejtoritë është shumë transparente dhe e hapur, prandaj kush ka para dhe tokë, unë i ftoj që të vijnë dhe investojnë në Gjilan, sepse kur investohet edhe hapen vende të punës.

Dezinformatorët nga DUMM kanë qëllime tendencioze ndaj meje si anëtarë i Kuvendit dhe si shef i grupit të LDK-së. Dezinformatore e parë është ish drejtorja e Drejtorisë, sepse ajo vazhdon me një punë tendencioze ndaj meje edhe tash. Të iu informoj se në ndërtimet që i kam bërë e kam plotësuar tërë dokumentacionin me 14 korrik 2011 dhe i kam plotësuar të gjitha kushtet për t’ i pajisur me leje ndërtimore për objektin “Agro-hermes 2”, kurse më 16 korrik 2013 më është lëshuar leja ndërtimore, do të thotë është lëshuar me vonesë prej 2 vjet e 2 ditë edhe pse e kam pasur komplet dokumentacionin.

Nevzad Isufi- së pari propozoj që për çështje personale mund të bisedohet herëve të tjera, sepse po ka shmangie nga pika e rendit të punës, sepse ne po flasim si institucion dhe jo për raste të veçanta individuale. Mandej po flasim për dukuri dhe mendoj se është detyrë e çdo qytetari e sidomos kur merr përgjegjësi, sidomos me vota që u tha këtu është që të denoncojë çdo dukuri negative që shkon në dëm

të çdo qytetari të vetëm. Ne jemi në seancën e nëntë të këtij vit dhe nëse asgjë nuk ka pasur me ndërtime, atëherë shtrohet pyetja pse kaq shumë herë të bëhet kjo kërkesë për të biseduar për ndërtimet në Komunë tonë? Unë mendoj se kjo është e papërgjegjshme që të kërkohej për nëntë herë të kërkohej një gjë e tillë dhe në fund të sillet kjo informatë si e tha drejtori e që unë do ta kisha konsideruar si mburrje për t' i raportuar këtij Kuvendi. Mandej nuk është fjala për të hyrat këtu, sikur kur e kemi një mall në treg dhe në fund të ditës e llogarisim sa kemi fituar? Këtu bëhet fjalë për plane afatgjate, për ndërtime të cilat më së paku duhet të zgjasin së paku 5 vite dhe nuk mund të bëhen ndryshime për çdo ditë. Mandej bëhet fjalë për pronat private tonat, por përndryshe nëse do të ishte që duhet të bëhet fjalë vetëm për pronat publike, atëherë ne qytetarët nuk do të kishim se pse të kërkonim leje, sepse do të bëjmë çka të dëshirojmë në pronat tona!? Është një organizmi institucional që edhe në prona private kërkohej disa kufizime dhe pikërisht për këtë jemi dhe jo të ndalen ndërtimet, sepse populli ka nevojë për ndërtime dhe zgjerim. Mirëpo qëllimi i jonë është që këto zgjerime individuale dhe për zgjerim biznesi është që këto të bëhen në bazë të dokumentacionit dhe në bazë të rregullave të cilat janë të përcaktuara me ligje. Unë mendoj se dëmi i mosrespektimit të planeve rregulluese, urbanistike është shumëfish më i dëmshëm se këto para të grumbulluara gjatë këtij viti që konsiderohet se janë më të mira se vitet e tjera. Ne nuk mund të kuptojmë se objektet e mëdha me mijëra katror mund të ndërtohen për pa e respektuar kushtet e ndërtimit, pa e respektuar hapësirën e lirë dhe për pa e respektuar çështjen e infrastrukturës dhe asgjë tjetër. Unë i kam fiksuar 3-4 objekt e të cilat nuk më intereson dhe nuk e di se të kujt janë si është objekti prapa soliterit të vetëm që dikur e ka pasur Gjilani e që mendojmë është objekt pa leje, bëhet fjalë për objektin te rruga Qarkore, Rruga "Dardania", është fjala për objektin te shkollat e mesme i cili thuhet se ka leje, por i cili për çudi paska të drejtë për të shfrytëzuar 100% hapësirën e tij për ndërtimi e si pasojë e të cilit objekt Gjimnazi duket si një objekt përdhes. Po ashtu është edhe objekti individual në rrugën e Prishtinës për të cilin objekt është shfrytëzuar sipërfaqja maksimalisht. Ne për këto dukuri negative jemi që të vihet një rregull dhe askush nuk është kundër asnjë ndërtuesi apo kompanie ndërtuese. Deri më tash nuk kemi pasur asnjë rrënim, gjithashtu u fol edhe për procedurat gjyqësore, por kaluan dy vjet dhe nuk kemi dëgjuar që është zhvilluar ndonjë procedurë gjyqësore për këto çështje. Shtrohet pyetja edhe sa duhet të pritët që të dalin ato dosje të famshme të njërës apo palës tjetër?

Riad Rashiti-mua nuk po më pëlqen debati i kolegut tonë z. Aliu, sepse ai po përgjigjet sikur të ishim në një seancë gjyqësore dhe ne nuk jemi në seancë gjyqësore, por po e diskutojmë problemin numër një në Gjilan. Nuk ka nevojë të personalizohen as investitorët e as uzurpatorët të cilët anë në Komunë të Gjilanit. Ne dimë se plani zhvillimor në Gjilan, nuk e lejon ndërtimin mbi 7 kate. Një objekt këtu në Gjilan 10 kate i ka të përfunduara. Listën që e kemi është një objekt për rrënim në emër të këtij zotërisë që po flet këtu!? Është nr. 9 emri i Kompanisë të tij dhe është vendimi nr. 07350100 të datës 29 shtator të vitit 2015. Unë nuk jam për rrënim, por është një dokument zyrtar që është lëshuar nga DUMM dhe flitet për këtë rrënim. Ne nuk e kemi quajtur askënd kriminel dhe as nuk do ta quajmë, por ndërtimet që po ndodhin janë krim urbanistikë, mendoj se duhet dalluar këto dy terme. Ne hakmarrje nuk kemi bërë ndaj askujt, por ju keni bërë ndaj ish drejtores së DUMM, sepse është larguar nga puna dhe është kthyer me vendim të gjykatës.

Nevzad Rushiti- duke u thirrur në atë se e kemi bërë riorganizimin e DUMM, unë besoj shumë që kemi formuar një ndër drejtoritë më të mira të mundshme në Gjilan. Duhet t' i dallojmë dy gjëra, ndërtimet dhe ndërtimet pa leje. Ndërtimet janë të lejuara nëse qytetari merr leje dhe nuk e shkel vijën rregulluese dhe planin urbanistik dhe këto ndërtime duhet t' i përkrahmi pa marrë parasysh se kush është? Nuk shoh xheloz, unë ftoj që hapësirën ta mbrojmë dhe sa më tepër të shkojmë në ndërtime të larta. Në këtë pjesën të Xhamia e Vogël ne kemi propozuar që Planin rregullues ta parashih ndërtimin 8+2, por o vetëm në këtë vend, por edhe në vende të tjera. Për këtë nëse nuk gabojmë unë kam qenë propozuesi

i parë për këtë ide. Këto fotografi që i keni bërë ju sipas meje është një lloj dezinformuatë, sepse shifrat që i dha drejtori dhe kryetari i Komunës buxheti në DUMM është rrit për 600 mijë €. Unë e inkurajoj edhe drejtorin dhe Inspeksionin që çdo objekt individual dhe kolektiv të bënë pagesën të marrin lejen dhe ato mjete të inkasohen në buxhetin e Komunës. Stafi i DUMM e njihni, sepse të gjithë janë arkitekt dhe ndërtimtar dhe kjo qeverisje nuk e ka punësuar askënd në këtë drejtori, me përjashtim që është emëruar shefi i Inspeksionit. Nuk do të thotë tash pse është LDK në qeverisje nuk punojnë ose punojnë keq dhe zhvillimin e Komunës sonë unë e dëshiroj me ndërtime të larta. Nuk po më kënaq që po thotë opozita se çdo që është keq në sferën e ndërtimit, sepse ne edhe kemi trashëguar ndërtime edhe me leje, por edhe pa leje.

Isa Agushi- unë mendoj se ne shqiptarët dezinformatat i kemi traditë, sepse po flasim pa argumente. Jemi të lumtur që janë këta investitor dhe investojnë në Komunë, sepse në të kundërtën këtu mund të shpërthejë edhe luftë civile. Papunësia është e madhe, varfëria e skajshme edhe këto ndërtime t'i ndalim si në Prishtinë si ka vepruar kryetari, nuk ka logjikë. Unë nuk jam për të ndërtuar në mënyrë të egër dhe nuk jam për të ndërtuar në pronë publike, por në pronë private nuk bën t' i pengojmë njerëzit.

Kush pajiset me dokumente të rregullta, ai mund të ndërtojë dhe ta zhvillojë Komunën tonë, përndryshe nëse nuk ka ndërtime në Komunën tonë nuk ka zhvillim ekonomik. Mandej këta njerëz që ndërtojnë në të ardhmen do të paguajnë edhe tatim në pronë të cilin tatim e inkason Komuna.

Unë jam i bindur se ne edhe 4 vite do ta marrim mandatin, sepse unë nëpër qytet po eci me sy hapur, kurse dikush po ec me symbyllur dhe nuk po e sheh se çka po ndodh në Komunë të Gjilanit.

Në Komunën tonë janë duke ndodhur investime të mëdha, por dikush nuk po i sheh ose nuk dëshiron për t' i parë.

Investime që kanë ndodhur që dy vite nuk kanë ndodhur për 15 vite, unë mund t' ia argumentoj secilit kur të dëshirojë. E dyta unë mendoj se DUMM është duke punuar mirë, por nëse dikush posedon argumente që ka shkelje të ligjit organet përkatëse janë, sepse ne nuk jemi institucion gjyqësor.

Nevzad Isufi- unë fola konkretisht për mos i ra rreth e rrotull, sepse unë e thash se ku është ujku, kurse dikush po thotë ja gjurmët. A doni fakt tjetër "Hip- Petrolin" a e keni biseduar në Kuvend? Ne i kemi dhënë vërejtjet tona, kurse drejtori i ka thënë se nuk ka leje, prandaj a është rrënuar ai objekt? Ka pasur premtime se do të rrënohet "Hib-Petrolin", a është realizuar ai premtim? Unë nuk e di se çfarë fakte po kërkon, sepse janë fakte që i sheh çdo qytetarë, kurse ju kërkon fakte të tjera?

Ne kemi dhënë edhe rekomandime këtu dhe gjenden rekomandimet e që është që të gjitha objektet pa leje të rrënohen të cilat vendime i ka DUMM edhe atë së paku deri më 31 janar 2006-2016. Të rrënohen edhe ato objekte private dhe të biznesit, investitorët të cilët nuk i kanë respektuar kushtet e ndërtimit dhe të bëhet ndarja e ndërtimeve, varësisht se ku gjenden? Në zonën e parë të qyteti të kenë tjetër kriter, krahasim me ato që janë në periferi. Nuk është vlera e njëjtë sikur ai që ndërton në qendër të qytetit sikur ai që ndërton në periferi.

Rexhep Kadriu- gjatë debatit u lakua edhe emri i im se gjëja shtëpinë e kam pa leje, por po i informoj anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët e Komunës së Gjilanit se unë posedoj me leje të shtëpisë private, ku jetoj me familjen time. Në seancën e radhës do ta sjell edhe lejen e ndërtimit e cila është nxjerr në vitin 2004, apo 2005.

Sahit Abazi- nëse na dëgjojnë qytetarët do të mbesin disi të habitur, sepse njëra palë thotë se kemi shumë ndërtime pa leje, kurse pala e cila është në pushtet tentoi për ta krijuar përshtypjen se nuk ka ndërtime pa leje. Devijimi i dytë e cila u fol shumë nga kryetari ishte çështja e ndërtimeve në pronat publike. Opozita nuk e ka kërkuar këtë seancë për ndërtimet në pronat publike, por ne kemi kërkuar seancë që të trajtohet tema e ndërtimeve pa leje dhe nuk duhet devijuar këtë temë. Në kuadër të kësaj

teme, qytetarët janë ata që vendosin mbi bazën e bindjes së tyre dhe secila palë ka të drejtë, kemi ne opozita që po themi se ka numër të madh të ndërtimeve pa leje, apo si po thotë pushteti se nuk ka fare ndërtime pa leje? Unë jam që të kemi një klimë relaksuese duke e respektuar ligjin. U tha nga Riadi në emër të grupit të PDK-së që ta propozojmë një komision për vlerësimin e tërë kësaj. Komisionet janë praktika parlamentare që krijohen në plotë raste bile edhe quhen komisione ad-hok. Ne si PDK jemi që këtë Komision ta udhëheq VV, është propozim i yni. Ju u munduat ta krijoni një bindje se gjëja PDK është kundër ndërtimeve, por të jeni të bindur se ndërtimet për 20 vitet e ardhshme do të jetë biznesi kryesor në Kosovë. Nuk do të kemi mundësi t' i ndalim ato, por përkundrazi do të jetë një ndër bizneset kryesore të Kosovës. Ne si PDK i inkurajojmë njerëzit që të ndërtojnë, por të ndërtojnë me leje dhe dallimi i vetëm është ky. Të ndërtohet me leje, sepse më vonë pasojat mund t' i bartin edhe këta ndërtuesit që sot ndërtojnë me leje. Ky është dallimi i jonë, krahasuar me qeverisjen e juaj, sepse keni lejuar shumë ndërtime. Ne propozojmë që të krijohet ky komision të cilin do ta udhëhiqte opozita dhe pas dy tre muajve do ta dimë se kush sa ka të drejtë.

Sa i përket fabrikës të cilën e përmendi z. Avdyli se mbyllet një fabrikë dhe hapet një tjetër këto nuk i takojnë fare Avdylit t' i flasë, sepse nuk është e thirrur Komuna drejtpërdrejtë për t' i mbrojtur fabrikat.

Luffi Haziri- mua më janë përmendur emra dhe lokalitete për ndërtim, prandaj kam dal në terren për t' u bindur vetë dhe më emër dhe mbiemër një x person është duke e ndihmuar një person tjetër për të ndërtuar pa leje. Unë kam dal në atë vend e kam përshëndet atë person dhe pas përshëndetjes i kam kërkuar se ka ndonjë letër, por situata ka qenë në rregull. Të gjitha këto që po fliten janë llafe dhe muhabete që mund të bëhen, sepse e vërteta ka dal në shesh dhe pa leje nuk kanë mundur të fillojnë për të ndërtuar. Ndërtuesit janë të njëjtë nuk kemi asnjë risi që ka mundur të ndodh, por unë e di se nuk i kanë paguar të gjithë lejet me kohë, mirëpo ne vazhdimisht i thërrasim dhe kërkojmë për t' i përmbush obligimet ligjore. Sa i përket "Hip-Petrollit", si procedurë unë e kam gjet me pëlqim urbanistikë dhe ka bërë kërkesë në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor për brezin e rrugës i cili ka marrë pëlqimin dhe më nuk ka mundësi askush që t' ia ndal lejen. Ligji është i qartë, sepse nëse Komuna nuk reagon në kërkesë, brenda 30 ditëve hyn në fuqi Ligji për marrjen e lejes dhe ka të drejtë secili operator për të filluar punën, kurse me leje e pajis Ministria e Planifikimit. Ne e kemi refuzuar nuk i kemi dhënë as pëlqim urbanistik, por ai zotëri në Ministri e ka nxjerr pëlqimin, kurse ne tash jemi në raporte me Ministrinë dhe vazhdimisht jemi duke bërë ankesë. Ligji nuk ka lënë ngulfatje, nuk ka më patronat as në këtë punë, ne e kemi rregullin tonë dhe do të vazhdojmë me ankesa për çdo situatë dhe çdo rast. Mirëpo ju e dini se për mosreagim me kohë sipas ligjit në fuqi Ministria e Planifikimit Hapësinor duhet të marrë veprime konkrete sikurse ka marrë në komunat tona. Për dy vjet është vetëm një rast, por ne do ta dërgojmë çështjen deri në fund.

Sa i përket krijimit të ambientit, Komuna e ka vetëm një detyrë për zhvillim lokal ekonomik, përshtatja e ambientit të qëndrueshëm për zhvillim ekonomik lokal . A mendoni se do të ketë zhvillim ekonomik dhe krijim të ambientit, nëse ne i pengojmë njerëzit për të mos marrë leje dhe për të ndërtuar në pronën e vetë. Ne këtë vit do të fillojmë me infrastrukturë me të gjitha bizneset e suksesshme në Gjilan e që përfshin rrugën nga Jabuqët në drejtim të Gumnishtës për Kompanisë "Dea", mandej rrugën nga Livoçi i Ulët në Čerñicë për "Consonin" dhe kompanitë e tjera në këtë lokalitet. Ndërtimin e të gjitha rrugëve për kompanitë bazike që kanë punëtorë dhe që punojnë, sepse kjo është detyra e jonë dhe nuk është detyra e jonë as për të penguar, as për të ruajt prodhimin në një vend ku nuk duhet të ruhet.

Nuk është problem me komisione dhe mbikëqyrje dhe monitorim, por mbikëqyrje të ligjit dhe kompromis me ligjin nuk mund të ketë. Ligi zbatohet ose nuk zbatohet dhe nuk kemi na nevojë për organ ndihmës i cili na e tregon a e kemi zbatuar ligjin apo nuk e kemi zbatuar ? Janë hetuesit që merren me atë punë dhe nëse nuk e kemi zbatuar ligjin, ata do të na akuzojnë neve. Nuk ka nevojë për të marrë kompetenca të ekzekutivit as të prokurorisë dhe nëse duhet për raste të tilla. Rekomandimet që i dëgjova nga anëtarët e Kuvendit, për të marrë veprime për rrënim, të merren veprime për të vendos

ligjshmëri aty ku duhet, natyrisht që unë i nënshtrohem edhe sikur mos të bie vendim fare KK unë i nënshtrohem.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- opozita (PDK) propozoi që të formohet një Komision për mbikëqyrje të ndërtimeve pa leje cili Komision do të formohet nga të gjithë grupet politike, por do ta udhëheq opozita konkretisht LVV. Ne jemi të gatshëm dhe jemi transparent që të formohet një komision i tillë, prandaj ju lus që të deklaroheni se kush është që të formohet ky komision?

Nuk aprovohet ky propozim, sepse për ishin 13 anëtarë për, kurse kundër 17 kundër, 1 nuk votoi.

Valon Shefkiu – sa i përket objektit të z. Avdyli, tregon shumë qarë se Inspeksioni e ka kryer punën e vetë dhe i ka proceduar të gjitha procedurat, por po e them me përgjegjësi se objekti për të cilin po flisni ka leje ndërtimi. Kanë leje ndërtimi edhe dy objektet e para e të cilat janë ndërtuar gjatë qeverisjes së kaluar dhe për atë duhet të merr përgjegjësi ajo qeverisje dhe jo tash ne. Është e vërtetë se është lëshuar leje fillimisht për P+7, por me vendimin mbi vlerën e kompensimit i cili është nxjerr në Kuvend tash e ka objektin të pajisur me leje ndërtimi.

Janë lëshuar disa vendime për rrënim, por ndërtuesit në ndërkohë janë pajisur me leje ndërtimi dhe nuk rrënohen objektet të cilat janë pajisur me leje ndërtimi. Komisione keni pasur të formuara shumë, por asnjëherë nuk është ndërmarrë asgjë (në qeverisjen e kaluar).

Po thuhet se planet rregulluese janë degraduar, por është e kundërta, sepse ne kemi filluar që mos t' i degradojmë ashtu siç ka ndodhur, por t' i zbatojmë ashtu si duhet, sepse kemi hapur trase të rrugëve në Fidanishte dhe do të fillojmë edhe në Kampin Montith dhe në “Livadhet e Arapit”. Ministria e Ambientit Hapësinor e kanë vizituar Komunën e Gjilanit dhe janë ndarë shumë të kënaqur me Komunë tonë, sepse nuk ka ankesa nga qytetarët. Tërë informatën më të plotë e keni edhe në raportin e punës së kryetarit për nëntë mujorin e vitit 2015.

2.3 Projekt Rregullorja mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale nr. 01. nr. 8355 të datës 09.07.2010

Hevzi Matoshi - KK me datë 9 korrik 2010, ka miratuar rregulloren për kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale. Sa i përket rregullores aktuale bazë për ndryshim dhe plotësim të rregullores është aprovimi i Statutit të Komunës më datë 6.11.2014.

Me automatizëm neni i fundit i rregullores thotë se në afat prej tre muajve të gjitha aktet duhet të jenë në harmoni me Statutin e Komunës. Sa për t' i njoftuar po e them se çdo mbledhje që nga mbledhja e parë e vitit 2014 dhe mars 2015 të gjitha aktet janë proceduar sipas rendit, por normalisht nuk kemi pasur mundësi të gjitha për t' i proceduar për tre muaj. Gjithashtu po iu njoftoj se kjo është rregullorja e fundit që harmonizohet, por në realitet ne nuk kemi qenë pa rregullore, por kemi bërë plotësime dhe ndryshime sa i përket interferimeve që kanë ndodhur sipas ndryshimeve në Statut. Në vijim të fjalës së tij z. Matoshi i citoi shumë nene në bazë të cilit do të plotësohet dhe ndryshohet kjo rregullore.

Avdyli Aliu- KPF- në mbledhjen e mbajtur më 20 nëntor 2015 pas shqyrtimit të propozimit nga Zyra Ligjore aprovoi propozimin për të shqyrtuar këtë rregullore dhe si të tillë e procedoi për shqyrtim në KK. Propozimi është përcjell edhe me material të nevojshëm shtesë dhe sigurisht jeni në dijeni se kjo rregullore ka ekzistuar edhe më parë që nga viti 2010, kurse tash po e harmonizojmë duke e përshtatur me disa dispozita të kësaj Rregullore dhe në bazë të Statutit të Komunës i miratuar nga KK.

Synohet që me këtë ndryshim të bëhen edhe më të qarta organizmi i kompetencave dhe përgjegjësitë e zyrave, sektorëve dhe drejtorive të Komunës së Gjilanit. Duke i votuar këto plotësime dhe ndryshime

i japim një qartësi edhe më të mirë punës së organeve të Administratës Komunale. Për grupin e LDK-kjo është në rregull dhe ne votojmë.

Shukrie Rapuca- kur është fjala për këtë rregullore e kam lexuar materialin dhe i kam dy vërejtjeje: “ Së pari e kam fjalën për Drejtorinë e Bujqësisë” e cila me këtë rregullore emërtohet Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari, por pasi që kjo drejtori po merret edhe me infrastrukturë siç janë rrugët e arave dhe të tjera, unë propozoj që kësaj drejtorie t’i shtohet edhe emërtimi shtesë “Zhvillimi rural”, sepse është kompetencë e kësaj drejtorie për këto zhvillime”. Nuk e kam të qartë pse iu është hequr kjo shtesë e emërimit”? Vërejtja tjetër është Zyra për Projekte e cila zyrë më mirë është të kalojë në kuadër të Zyrës për Zhvillim Ekonomik, sepse aktiviteti i kësaj zyre në tërësi përputhet me zhvillim ekonomik dhe jo me Zyrën e Prokurimit.

Nevzad Isufi- ne i kemi disa vërejtje sa i përket kësaj Rregulloreje, sepse me Planin e punës së Kuvendit është deshtë të parashihet koha e shqyrtimit të draft projektit të kësaj rregulloreje dhe rregulloreve të tjera të cilat janë miratuar deri tash në seanca të Kuvendit. Neni 101 i Statutit të Komunës parashihet se me aprovimi e këtij statuti të gjitha aktet e tjera të Komunës të harmonizohen brenda tre muajve sipas Statutit në fuqi. Ky projekt po analizohet dhe debatohet me një vonesë prej 10 muajve, kurse afati i fundit ka qenë për miratim muaji shkurt i këtij viti. Kemi bindjen se gjatë tërë këtij viti Kuvendi ka punuar pa rregullore dhe jo në harmoni me statutin të cilin e kemi aprovuar.

As ky projekt, as projektet e tjera të cilat janë aprovuar në seancat e tjera të seancave të Komunës, paraprakisht nuk janë debatuar në Komisionin statutar dhe për akte normative si trup profesionale e përbërë nga ekspertët të Administratës Komunale dhe partive politike të përfaqësuara në Kuvend.

Përfaqësuesi i ynë pas shqyrtimit të Statutit të Komunës, nuk është ftuar asnjëherë në ndonjë seancë të këtij Komisioni. Kjo do të thotë se kemi bërë shkelje procedurale për aprovim të këtyre rregulloreve, sepse nuk e ka mbështetjen e Komisionit për ndryshim të Statutit dhe akteve tjera normative.

Ne propozojmë që kjo rregullore të kthehet në shqyrtim të Komisionit për ndryshime Statutare, pastaj të vijë për shqyrtim dhe aprovim në Kuvend.

Shpërbërja e Drejtorisë së Inspeksionit dhe DKRS-së është bërë në kundërshtim me rregulloren në fuqi për Organizim dhe kompetenca të Administratës Komunale. Shpërbërja e Drejtorisë Komunale të Inspeksionit dhe DKRS-së është bërë në kundërshtim me Rregulloren për organizim dhe kompetenca të organeve të Administratës Komunale. Në bazë të nenit tetë (8), citat “ Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit për Administrim të Pushtetit Lokal”. Kemi edhe vërejtje të tjera në formulime, por kjo duhet të shqyrtohet së pari në Komisionin Statutar.

Selami Xhemajli- ne e kemi obligim ligjor që krahas ndryshimeve që kanë ndodhur në Statutin e Komunës së Gjilanit edhe kjo Rregullore që po e debatojmë të jetë në harmoni me ndryshimet që kanë ndodhur në Statutin e Komunës së Gjilanit, prandaj unë i besoj punës së Zyrës Ligjore, e që mund të ketë ndonjë gabim teknik, por që mund të korrigjohen, mirëpo në parim ne e përkrahim strukturën e re të organeve të Administratës Komunale dhe përgjegjësitë që janë përcaktuar. Në emër të grupit të AAK-së ne e përkrahim këtë rregullore.

Hevzi Matoshi –sa i përket emërimit të Drejtorisë së Bujqësisë për të cilën pati vërejtje, ne e përmendëm edhe datën kur është aprovuar Statuti i Komunës dhe në nenin 84 janë të gjitha drejtoritë e radhitura dhe të gjitha janë të emërtuara. Drejtoria për Bujqësi sipas radhës është nr. 7 dhe quhet Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë.

Sa i përket kohës së për nxjerrje të akteve në harmoni me Statutin e Komunës, ne me përgjegjësi të plotë mund të themi se asnjëherë deri më tash nuk jemi ndal jashtë ligjit dhe të gjitha aktet sipas radhës i kemi proceduar, por kjo rregullore është shumë voluminoze dhe ka qenë deshtë të punojmë

pak më gjatë, por edhe paraprakisht është nxjerr edhe organogrami i Komunës i cili është harmonizuar me Statutin e Komunës dhe është bërë lëvizshmëria e drejtorive gjegjësisht sektorëve nëpër drejtori.

Nuk pati debatues tjerë, kurse kryesuesja kërkon që anëtarët e Kuvendit të deklarojnë se kush është për aprovim të pikës 2.3 të rendit të punës.

Aprovohet pika 2.3 e rendit të punës: **3** Projekt Rregullorja mbi ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale nr. 01. nr. 8355 të datës 09.07.2010 me 21 vota për, 5 kundër, kuse 5 abstenime.

2.4 Projekt Plani strategjik lokal për trajtimin dhe parandalimin e Korrupsionit

Hevzi Matoshi- arsyetimin për këtë pikë të rendit të punës e dha zyrtari ligjor Hevzi Matoshi të cilin arsyetim anëtarët e Kuvendit e kanë në material të seancës.

Fehmi Sylejmani- edhe përkundër që është obligim ligjor, ne konsiderojmë se ky plan në të cilin flitet edhe për lejet e ndërtimit dhe të shërbimeve komunale, konsiderojmë se paraprakisht duhet të dërgohet në Komitetin për Urbanizëm dhe në atë për Shërbime Publike, mandej të vijë me vërejtje dhe sugjerime të atyre që i japin.

Avdyl Aliu- ky dokument paraqet një projekt-plan strategjik për trajtimin dhe parandalimin e korrupsionit në Komunën e Gjilanit. Fakti se po merremi me këtë plan nuk do të thotë se ka rritje të kësaj dukurie ne gative në Komunën tonë, por gjithnjë jemi më mirë në këtë aspekt. Mirëpo me trajtimin e këtij problemi synohet që edhe më shumë të tkurret ky fenomen negativ. Edhe këtë plan e kemi trajtuar në KPF dhe i kemi dhënë vizë për ta trajtuar të gjithë së bashku dhe ta aprovojmë që ky dokument në të ardhmen të na shërbejë për rritje të performancës nga ky aspekt. Misioni i këtij plani është i qartë, sepse Komuna e Gjilanit ka si mision qeverisjen e komunitetit të saj duke u mbështetur në ligjet e Republikës së Kosovës, transparencën dhe profesionalizmin duke synuar rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucionit të Komunës.

Në mënyrë të qartë shihen aktivitetet për t' i arrit objektivat dhe këto qëllime. Me vullnet dhe me përkushtim tonë nuk dëshirojmë që mos të jetë një dokument sa për ta përmbushur një nevojë standarde dhe të përfundojë në sirtar, ne e votojmë si dokument të rëndësishëm.

Bujar Nevzadi- cila është arsyeje që e keni sjell për aprovim këtë plan strategjik? Unë më parë në pikën për ndërtime në Komunë të Gjilanit u habita pse nuk e votuat komisionin të cilin e propozuam? Ne thamë se po mungon transparenca, sepse komandant "Dardani" e tha se këto dy vite është punuar më shumë se 12 vite më parë, kurse ne e thamë se është dhënë mito dhe nuk është punuar. Janë vonuar tenderët një kohë të gjatë derisa është gjetur mënyra për ta bërë pazarin!? Cilësia e punimeve është shumë e dobët dhe për atë arsyeje kërkuam komision për të dalë në terren dhe për t' i parë se çfarë cilësie kanë ndërtimet dhe infrastruktura në përgjithësi. Nuk ka pasur komisione mbikëqyrëse është punuar shkel e shko, prandaj unë nuk e votoj këtë plan dhe i ftoj anëtarët e Kuvendit që mos ta votojnë, sepse kjo është në letër sa për mbulesë, kurse punë konkrete nuk ka !?

Valentine Bunjaku-Rexhepi – i lus mjetet e informimit dhe le ta marrin dhe le ta citojnë se unë edhe në debat me Lëvizjen fol edhe këtu po e them nëse ka mito dhe korrupsion të lutem lajmëroje, sepse unë do ta dërgoj lëndën në organet e hetuesisë. Nëse ka dukuri të tilla unë personalisht jam në gjendje për ta bërë një denoncim edhe për drejtorin tim apo ndonjë anëtarë të Kuvendit.

Ta argumentojnë haptas z. Nevzadi këtë që po e thotë, ta argumentojë publikisht. Kush merr mito këtë? A ka argumente bazike z. Nevzadi. ?

Bujar Nevzadi – ju jeni kryesuese dhe disa herë të kam thënë mos e merr rolin e ekzekutivit dhe lejoni që të debatohet ashtu si duhet. Të del drejtori i Zyrës së Prokurimit dhe të thotë çdo gjë është në rregull ?

Nuk pati debatues të tjerë kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.4 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.4 e rendit të punës: Projekt Plani strategjik lokal për trajtimin dhe parandalimin e Korrupsionit, me 19 vota për, 10 kundër, kurse 3 nuk kanë votuar.

2.5 Draft Plani lokal i veprimit për riintegrim

Burim Elezi – Planin e veprimt për integrim e paraqiti, zyrtari për integrim Burim Elezi të cili plan anëtarët e Kuvendit e kanë në materialet e tyre.

Nuk pati debatues të tërë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.5 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.5 e rendit të punës: Draft Plani lokal i veprimit për riintegrim, me 27 vota për, një kundër dhe 4 abstenime

2.6 Propozim Vendimi për themelimin e Grupi punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit.

Isa Agushi – në emër të grupit të LDK-së ne e propozojmë: Nevzad Rushitin dhe Myzaferë Ismailin. Nga LVV, Fehmi Sylejmani vullnetarisht tërhiq nga ky grup punues.

Në emër të grupit të PDK-së ne propozojmë që në këtë grup punues përsëri të jetë Riad Rashiti.

Në emër të grupit të AAK-së propozohet Adelina Berisha.

Sadulla Kadriu nga “Vatra” tërhiqet vullnetarisht nga ky komision.

Fehmi Sylejmani- VV nuk ka propozim, sepse kur ne tentonim të propozojmë ndonjë kandidatë ne komisione ju na keni injoruar, prandaj në shenjë revolte tërhiqemi nga ky komision.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- Komisioni do të jetë i përbërë prej 7 anëtarëve, prandaj ju lus të deklaroheni se kush është për këto propozime?

Aprovohet pika 2.6 e rendit të punës: Propozim Vendimi për themelimin e Grupi punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit, me 22 vota për, 4 kundër, kurse 6 nuk kanë votuar.

2.7 Riorganizimi i përbërjes së Komiteteve të KK-Gjilan

Valentine Bunjaku-Rexhepi- kryesuesja e lexon listën e përbërjes së Komiteteve e cila listë gjendet

në sekretari të Kuvendit, përkatësisht te shefi i Njesisë së Kuvendit Sadri Arifi.

Aprovohen këto ndryshime të cilat i lexoi dhe u propozuan nga anëtarët e Kuvendit me 20 vota për, 3 kundër, kurse 9 nuk kanë votuar.

Të ndryshme

Krenare Latifi- i kam tri pyetje për Drejtorinë për Buxhet dhe Financa: sipas raportit të punës së kryetarit të Komunës për periudhën janar –shtator 2015 në pjesën ku trajtohet angazhimi i Njesisë së personelit në pjesën tabelare qëndron e dhëna se për 9 muaj të këtij viti janë nënshkruar 260 kontrata në vepër. Mirëpo këto kontrata vazhdojnë për çdo muaj, prandaj pyetja ime është se nga cilat mjete ose fonde bëhet pagesa e tyre dhe a praqet shkelje ligjore kjo mënyrë e pagesës?

Gjithashtu me rastin e aprovimit të buxhetit për vitin fiskal të vitit 2016 shpenzimet kapitale në vlerë prej mbi 4 milion e 400 mijë €, janë shpërndarë në nëntë fusha, por pa emërtim të projekteve konkrete dhe pa destinim të mjeteve. Një veprim i tillë a është në pajtim me menaxhimin e financave publike?

Pyetje tjetër është se në vendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Gjilanit për vitin 2016 në pjesën tabelare parashihet se në fushën e investimeve publike do të investohet shuma e përgjithshme prej 867 mijë €, por pa e caktuar destinimin dhe për pa i përcaktuar projektet konkrete. Si do të destinohen këto mjete financiare pa projekte konkrete?

Zijadin Maliqi- unë e pata një pyetje nga VV për regjistrim të pasurisë së Komunës, por unë edhe më pare e kam thënë se regjistrimi i pasurisë është bërë, por kanë mbetur vetëm dy shkolla edhe ato janë Gjinnazi “Xhavit Ahmeti” dhe Shkolla Fillore” Sadullah Brestovci”. Këto dy shkolla janë regjistruar në Ministri të Arsimit, prandaj nuk ka mundësi të bëhet regjistrimi në dy vende.

Ne e kemi bërë kërkesën për regjistrimin edhe të këtyre dy shkollave për të na dhënë leje që ne t’ i regjistrojmë këto dy shkolla, sepse janë pasuri e Komunës. Ne i kemi bërë përgatitjet për regjistrimin e pasurisë për këtë vit dhe kryetari i ka formuar tri komisione, si atë për regjistrim të pasurisë dhe për vlerësim të pasurisë edhe komisionin për vlerësim të stoqeve.

Sa i përket buxheti kemi biseduar edhe kur është aprovuar buxheti, prandaj edhe te shpenzimet kapitale edhe te shërbimet publike janë paraparë mjetet për destinacione të caktuara, janë në përputhshmëri me ligjin dhe sikurse mos të ishin në pajtim me ligjin nuk do të ishin inkorporuar në Ligjin mbi buxhetin. Ne kemi paraparë investime me donatorët, por paraprakisht ne nuk jemi në gjendje për ta ditur se cilat investime do t’ i bëjnë donatorët gjatë vitit të ardhshëm, por i kemi paraparë si tërësi, mandej si pas marrëveshjes që bëhet me investitorin e huaj i ndan Komuna.

Sa i përket kontratave në vepër unë nuk kam njohuri sa kontrata të tilla, sepse ne buxhetin ia ndajmë drejtorive dhe secila drejtori menaxhon me pjesën e vetë të buxhetit. Këtë përgjigje duhet kërkuar në Zyrën e Personelit, por me sa e di unë ka qenë në numër i madh me kontrata të tilla, por tash është një numër i vogël i tyre.

Fehmi Sylejmani – këtu nuk është personi përgjegjës për sport, atëherë edhe kryetari mund të përgjigjet. Së pari çfarë hapash është duke ndërmarrë Komuna në vazhdimin e punimeve në ndërtimin e Bibliotekës Regjionale? Kërkojmë që për këtë Bibliotekë të bëhet një raport i cili së pari duhet të shqyrtohet në Komitetin për Kulturë, pastaj në KPF.

Cilat janë arsyt e mos hartimit të një rregullore për “Flakën e Janarit”, sepse ky festival që nga fillimi është pa rregullore? Cilat janë arsyt e mospërfundimit të fushës së futbollit afër varrezave të qytetit? A japin llogari klubet e futbollit të cilave Komuna është duke iu ndihmuar dhe unë iu përgëzoj për ndihmën që e keni dhënë deri më tash për klubet sportive, por kërkoj që të japin llogari,

sepse kemi dyshime në disa klube se mund t' i keqpërdorin ato mjete?!

Për drejtorin e Bujqësisë si po realizohet mirëmbajtja e drunjve dekorative të mbjella para dy viteve?

Lutfi Haziri- i falënderoj të gjithë ata që kanë bërë pyetje, prej të cilave në disa u përgjigj kryesuesja.. Sa i përket Bibliotekës Regjionale ne kemi arrit për t'i deblokuar punimet në këtë bibliotekë dhe kontraktori kryesor i këtij projekti është Komisioni Evropian dhe para dy ditë ka qenë ekipi i ri i ngarkuar nga donatori për prerjen apo revidimin e projektit, sepse kanë kaluar disa vite dhe janë dëmtuar në masë të madhe punimet deri në këtë fazë. Pas vlerësimit teknik të mbikëqyrës, ne do të ngarkojmë mbikëqyrje të re të Komunës sipas kontratës dhe do të kërkojmë dinamika të reja me marrëveshje të re për përfundim të punëve në këtë Bibliotekë.

Shpresojmë se në vitin e ardhshëm do të përfundojnë punimet në këtë Bibliotekë.

Në të njëjtën logjikë kemi punuar edhe për fushën e sportit e që donator është KE, sepse punimet janë bllokuar dhe ne po bëjmë presion që donatori t' i përfundojë punimet dhe ta bëjë pranim – dorëzimin. Dy data janë shtyrë, sepse ne nuk e kemi pranuar objektin, sepse ka pasur mangësi gjatë punimeve. Pa u realizuar i tërë objekti ashtu siç parashihet ne nuk e pranomë objektin.

Objekti i tretë i mbetur me investim jashtë Gjilanit, është i MPM-së për të cilin objekt kemi biseduar me kryeministrin dhe ministrin dhe me organet përfituese si policinë dhe jemi në fazën e revidimit të prerjes së projektit, sepse edhe ky është problem gjyqësor. Vullneti i mirë është që të bëhet prerja dhe revidimi, sepse ka filluar në vitin 2008 dhe tash është degraduar objekti.

Po ashtu e kemi një numër të madh të projekteve, 17 sipas listës sonë, kurse 27 sipas një liste më të vjetër, projekte të filluara, por janë stopuar për arsyeje të ndryshme dhe njëra prej tyre është Salla e Përlepnicës. Neve na është deshtë për ta bërë revidimin e projektit, incizimin e ri dhe t' i kompletojmë dosjet në dokumentacion përkatës, të gjejmë mjete dhe ta mobilizojmë punën dhe ta rifillojmë ndërtimin e objektit. Në këtë gjendje është rruga e Kosaçës, ajo për Malishevë të Re dhe rrugëve të tjera në qytet për të cilat do të bëhet revidimi i plotë dhe ne nuk jemi të interesuar në asnjë mënyrë humbjen e mjeteve që janë investuar.

Në Komunë të Gjilanit pritet që të hyjnë një shumë e mirë e mjeteve për investime dhe kjo nuk është meritë e individit, por është meritë e angazhimit të përbashkët. Masa e investimeve publike vitin e ardhshëm pritet që të jetë më tepër se buxheti i Komunës. Këto investime do të bëhen nga disa të hyra, së pari nga të hyrat komunale, sepse nga të hyrat komunale ne presim që t' i inkasojmë nga amnistia e borxheve, kurse 9.2 milion sipas ligjit janë në procedurë të shlyerjes. Afër 5.2 milion € vijnë më Gjilan si pasojë e vijave ministore, kryesisht nga Ministria e Infrastrukturës e cila merr pjesë në ndërtim të rrugëve të Gjilanit që lidhen me rrugë regjionale apo ndër regjionale.

Së pari do të fillojmë me ndërtim të hyrjes në Gjilan deri te Penda e Livoçit të Epërm dhe Gjilan-Ferizaj deri te Livoçi i Ulët dhe Gjilan- Bujanc që është pjesë e angazhimeve tona. Në financim do të merr pjesë edhe Banka Ekonomik për Zhvillim Evropian dhe BERZH- e cila e ka bërë incizimin e parë në Gjilan dhe e cila sipas marrëveshjes së mekanizmit të ri të Berlinit, Gjilanin e ka vendosur në projekt të rrugëve infrastrukturore për shkak të degradimit dhe gjendjes aktuale që është.

Pjesa tjetër lidhet me disa programe që kemi si ai në “Dardani” është “Kosova e Bukur” dhe është programi me Qeverinë Amerikane e që është program për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve në Dardani. ” Programi me TIK-ën turke po ashtu për ndërtim të çerdhes së fëmijëve në Lagjen “Arbëria”. Ne kemi konkurruar me programin për trajtim të ujërave të zeza i cili program është pranuar dhe ne aplikacionin e kemi bërë për 12 milion € që përfshin rregullimin e Lumit Stanishorka, 54 km gyp për kanalizime për qytetin dhe fshatrat e Komunës së Gjilanit.

Programi tjetër është programi me Qeverinë e Zvicrës e cila merr mbi vete tretmanin e ujërave dhe ujit të pijshëm, rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit për Komunë në pjesët urbane dhe në fshatrat e Komunës së Gjilanit e që vlera është tre milion €. Kemi edhe programe të tjera më të vogla të cilat

në asnjë mënyrë nuk i kemi injoruar, sepse ne sot e kemi aftin ligjor për të konkurruar në IPA-2 i cili është program i Komisionit Evropian.

Në vijim të fjalës së tij kryetari i sqaroi edhe shumë projekte tjera të cilat do të realizohen përmes vijave ministrore.

Sa i përket çështjes së shefit të kabinetit tim Arbër Ismaili, është emëruar shef i Kabinetit sipas rregullores së re për emërimet nga kryetari i Komunës, sepse kryetarit të Komunës i lejohen dy pozita për t' i emëruar. Pozitën e parë e ka të shefit të kabinetit dhe të dytën asistent administrativ dhe këto nuk janë pozita të shërbimit civil, por pozita që emërohen nga ana e kryetarit dhe i lihet mundësia e përcjellësit ose shoferit. Arbër Ismaili ka bërë kërkesë për ta liruar për një kohë, por gjithashtu ka punuar prej distancës dhe është angazhuar, por përveç pushimit të rregullt që e ka shfrytëzuar, për pjesën tjetër ka qenë i angazhuar për atë që ka kërkuar për të qenë i angazhuar, sepse një i angazhuar politik nuk e ka të obliguar t' i nënshtrohet një orari strikt të angazhimit në Komunë.

Të angazhuarit politik mund të angazhohen në punë, mund të jenë 12 apo 24 orë në punë, atë që ka nevojë dhe natyrisht se të angazhuarit politik kanë nevojë për një orar më të gjatë.

Niveli i transparencës dhe KDI, Komunën e Gjilanit e ka ruajtur nga 38 Komuna apo nga 10 të cilat janë monitoruar. Niveli i monitorimit është bërë nga KDI-ja në mbikëqyrje të Web sajtit të Komunës dhe nuk ka indikator shqetësues, por ka indikator në mënyrë që të angazhohemi për daljen e ndërkomunat e para. Komuna e jonë këtë vit ka dalë e dyta, por ne i kemi indikatorët se ku mund të përmirësohemi për vitin e ardhshëm.

Tek trotuari "Mulla Idrizi" dhe disa rrugë të tjera që janë në plan për të përfunduar këtë vit, nuk ka ngecje sipas planit dinamik të paraqitur në kontratë, por ka ngecje sipas asaj që ne kemi pasur dëshirë për ta parë. Rruga "M. Idrizi" është rruga më e vjetër në qytet e ndërtuar më 1977 nga ana e Fabrikës së Radiatorëve në atë kohë dhe ka pasur një standard ndërtimi, por për herë të parë ka filluar të ndërtohet këtë vit. Para dy vite ka filluar trotuari për t' u rregulluar standardi i rrugës, sepse gjerësia e rrugës për automjete nuk ka qenë e njëjtë sikur të Xhamia e Vogël deri në përfundim të sajë.

Kemi pasur prej 4-6 m rrugë dhe kjo ka bërë që edhe trotualet mos të jenë të njëjta në rrugë, prandaj ne e kemi hartuar projektin e ri të rrugës "M. Idrizi" e cila rrugë i ka standardet e njëjta për këmbësor në të dy anët dhe i kemi eliminuar disa probleme që kanë qenë kryesisht shkallë të shtëpive dhe hyrje dalje të oborreve të cilën njerëzit e kanë shfrytëzuar kur është ndërtuar ajo lagjeje dhe tash e kemi një rrugë me projekt të ndërtimit dhe ka kushte të komunikacionit

Sa i përket Shtëpisë së Kulturës në Përlepnice unë e sqarova më parë, por po them përsëri se është një projekt i cili është ndërprerë në kohën e kryerit Mustafa në detyrë në atë kohë më 15 dhjetor.

Ne e kemi plotësuar dokumentacionin dhe e kemi bërë revidimin, mjetet i kemi tash dhe do t' i epet atributi asaj sille çfarë e ka. Ajo sallë i ka elementet e shenjta e cila duhet të hyjë nën mbrojtje për trashëgimi si objekt, sepse rezistenca më madhe që ne e atribuojmë ka qenë nga ajo shtëpi dhe nga ai fshat. Ne sa herë që kemi shkuar në atë fshat e kemi pasur edhe sofër ku jemi ushqyer, por edhe vend ku jemi mbrojtur. Në këtë shtëpi janë vonuar punët, por kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së projektit detaj dhe mungesës së dokumentacionit. Mirëpo edhe në disa projekte e kemi problemin e njëjtë. Sa i përket emërimit të rrugëve jemi në fazën e fundit të riemërimeve, të rrugëve, shesheve dhe pjesëve urbane, por edhe për tërë territorin e Komunës së Gjilanit.

Parkingu te Wiva freshi është vendim i KK dhe unë e kam respektuar, por kurdo që i duhet shkollës ajo pesë e rrugës duhet ta rishqyrtojmë, por duhet sjellë në KK.

Jemi munduar për ta ruajtur gjelbërimin dhe jam njëri prej atyre që e kundërshtoj çdo prerje dhe lëndim të drunjve dekorative, por duhet vazhduar me gjelbërim të qytetit dhe ne i kemi kushtuar rëndësi kësaj faze fillimisht të konservimit të varrezave të qytetit për të mbjellë drunj, sepse konservimi nënkupton mbjelljen dhe vendosjen e drunjve në mënyrë që varrezat e qytetit të fillojnë të mbyllën me drunj.

Në Varrezat e Dëshmorëve kemi mbjellë nga një dru për çdo hero dhe dëshmorë i cili do ta ketë

emrin e Dëshmorit. Do të vazhdomë me pjesë urbane të qyteti, tash është Arbëria me plan dhe drunj do të ketë në rrugën e Malishevës në drejtim të Bujanocit.

Zjarrfikësit e përmenda se janë të Shoqatës së Vullnetarëve dhe ne kemi një marrëveshje nga ish kryetari dhe është vazhduar edhe këtë vit, por jam duke punuar me Agjensonin Shtetëror për ta zgjidh këtë problem.

Sa i përket kërkesave me shkrim secili drejtor ose zyrtar është i obliguar të kthejë përgjigje në afat ligjor, kurse sa më përket mua unë i kam pasur tri pyetje nga z. Riad Rashiti, por i kam kthyer në afat ligjor.

Sa i përket dëmtimit të gomave të Komunës, unë nuk kam bërë akuzë, por është nxjerr si e tillë nga mjetet e informimit, por edhe unë kam kërkuar si ju që policia t' i bëj hetimet dhe për ta parë se kush ka qenë?

Leonorë Bunjaku-kërkoj vetëm një përgjigje se deri ku është arrit me objektin e Ekonomisë së Pyjeve i cili objekt gjendet në kompleksin e shkollave të mesme. Vazhdimisht e kam bërë këtë pyetje, prandaj edhe sot më intereson se a ka ndonjë lëvizje

Lutfi Haziri- ky është një problem tjetër dhe ne e kemi kërkuar listën e pronave nga Agjensioni i Privatizimit ku hynë edhe Ekonomia e Pyjeve për t' ia dhënë në interes për shfrytëzim të Komunës së Gjilanit. Në këtë rast neve nuk na duhet objekti, por na duhet toka për nevojat e Gjimnazit.

Të njëjtin status e ka edhe Bankosi- edhe disa prona të tjera duke i përfshirë edhe varrezat e reja të qytetit që ne i kemi kërkuar një pjesë të tokës për të na i kthyer AKP-ja.

Në mungesë të Bordit të Agjencionit të Privatizimit ende nuk janë shqyrtuar lëndët tona. Ajo që do të ndërmarrim ne është se do ta rrënojmë objektin e Agjencionit të Pyjeve, sepse atyre i kemi ofruar lokal pa qira në Inkubatorin e Biznesit.

Shukrie Rapuca- te Shkolla Filllore “Abaz Ajeti” është duke u ndërtuar salla e edukatës fizike, por janë bërë ndryshime në projekt, sepse është zvogëluar hapësira, prandaj kam pyetje pse po ndodh ky zvogëlim? Është ndryshuar komplet dimensionin e sallës për të cilën kemi pasur nevojë të madhe.

Lutfi Haziri- projekti nuk është ndryshuar dhe ju e dini se është investim i Ministrisë së Arsimit në bashkëpunim me Komunën kjo sallë edhe e Shkollës Filllore “Liria” në Pogradë. Ne problemën e kemi pasur me një qytetar i cili pretendon se ka pronë private afër oborrit të shkollës, por në regjistrat tonë kadastral të verifikuar tash, ajo pronë është ekspropriuar dhe është pronë e Shkollës Filllore “Abaz Ajeti.” Sa i përket projektit unë nuk jam njoftuar se është zvogëluar, sepse nuk mundet askush ta prek projektin dhe në momentin që fillon puna nuk mund të preket. Nëse është zvogëluar ne mund të kërkojmë në Ministri të Arsimit dhe të Ministrisë së Administratës Publike për të parë se ku qëndron arsyeja që ka ndodhur ky ndryshim nëse vërtetë ka ndodhur?

Ne në atë oborr të shkollës kemi planifikuar që të ndërtohet edhe çerdhja e fëmijëve në mënyrë që të plotësohet infrastruktura edukative në atë lagjeje për vitin e ardhshëm.

Me këto debate dhe vendime seanca i përfundoi punimet në ora 17.25 min.

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku –Rexhepi